



INSTITUCIONET QENDRORE MOBILIZOHEN PËR T'I DALË
NË NDIHMË KOMUNËS SË DEÇANIT

ENDE NUK DIHEN SHKAQET E HELMIMIT NË DEÇAN

FAQE 4-5

- Disa mostra të helmimeve në Deçan do të testohen jashtë Kosovës



Kanë kaluar katër ditë nga raportimi i rasteve të para të helmimit të qytetarëve në Deçan, por ende nuk dihet shkaktori i helmimit. Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka bërë me dije se disa

mostra të ujit do të dërgohen për analiza të mëtejshme jashtë vendit. Derisa institucionet po bëjnë përpjekje për ta gjetur shakatarin e helmimit, qytetarët e Deçanit edhe të mërkurën

kanë vazhduar të kërkojnë ndihmë mjekësore. Sipas autoriteteve lokale, vetëm në 24 orët e fundit qindra persona kanë kërkuar ndihmë mjekësore

AKTUALE



POLICIA IDENTIFIKON
DYMBËDHJETË VETURA ME
REGJISTRIM TË SKADUAR F. 6

AHMETI: QENDRA E
MJEKËSISË FAMILJARE
NË VETERNIK DO TË
FINALIZOHET DERI NË FUND
TË KËTIJ VITI F. 7

VOUÇIQI: NUK DI NËSE
DO TË KETË PËRPARIM NË
DIALOGUN ME KOSOVËN F. 3

EKONOMI

KOMISIONI PËR BUXHET VOTON
RAPORTIN PËR PROJEKTLIGJIN
PËR AUTOMJETE F. 8

QEVERIA MIRATON PAKON PËR
RINGJALLJE EKONOMIKE NË
VLERË PREJ 423 MILIONË
EUROSH F. 8

SPORT

KUKA: NË SANJO DO T'I
PËRSHTATEMI KLIMATIZIMIT
TË KOHËS DHE DO TË KEMI
PËRGATITJE F. 13



**MBROJTJA E
GUCATIT DHE
E HARADINAJT:
JEMI GATI PËR
GJYQ PAS 30
GUSHTIT**

FAQE 5



**ZGJATET ORARI
I GASTRONOMISË DHE
SALLAVE TË DASMAVE**

FAQE 8

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Merkeli u thotë gjermanëve të vaksinohen për të pasur më shumë liri

BERLIN, 14 KORRIK - Kancelarja gjermane Angela Merkel u bëri thirrje qytetarëve gjermanë që të vaksinohen kundër koronavirusit, duke thënë se sa më shumë njerëz që vaksinohen, aq më shumë liri do të ketë. Normat e vaksinimit në Gjermani kanë rënë në javët

e fundit. Sipas shifrave zyrtare, rreth 58.7 për qind e qytetarëve gjermanë kanë marrë së paku një dozë të vaksinës, ndërsa 43 për qind janë vaksinuar plotësisht. Instituti për Kontrollin e Sëmundjeve në Gjermani "Robert Koch" ka thënë

javën e kaluar se vendi duhet ta synojë vaksinimin e 85 për qind të njerëzve të moshave 12-59 vjeç dhe të 90 për qind të njerëzve mbi 60 vjeç, për ta parandaluar variantin "Delta" të koronavirusit që të shkaktojë rritje të numrit të rasteve në vjeshtë dhe dimër.

"Delta", sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, përhapet më shumë se variantet e mëparshme. "Sa më shumë njerëz që vaksinohen, aq më shumë të lirë do të jemi", ka thënë Merkel, e cila është vaksinuar plotësisht kundër koronavirusit.



BE-ja prezanton planin për luftim të ndryshimeve klimatike

BRUKSEL, 14 KORRIK - Bashkimi Evropian ka bërë me dije planet rreth ndryshimeve klimatike teksa synon të luftojë emetimet e karbonit deri më 2050. Propozimet e bëra duhet të miratohen nga 27 vendet anëtare të Bashkimit Evropian si dhe nga Parlamenti Evropian. Në to përfshihen vënia e taksës për kerozinë dhe ndalimi i shitjes së makinave me benzinë apo naftë brenda 20 vjetëve. Këto propozime pritet të negociohen disa muaj. "Duke vepruar tani, ne mund t'i bëjmë

gjërat ndryshe dhe të zgjedhim një rrugë më të mirë dhe më të shëndetshme për të ardhmen", ka thënë presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen. Këto masa mund të rritin faturat për ngrohje shtëpiake si dhe të rritin çmimet e fluturimeve brenda bllokut evropian. Në propozime është përfshirë edhe ndarja e fondeve për t'u ndihmuar familjeve që të bëjnë ndryshimet e nevojshme nëpër shtëpitë e tyre. Zërat opozitarë ndaj këtyre



propozimeve pritet të vijnë nga disa liderë të industrive, si ajo e aeroplanëve dhe prodhuesve të makinave, por edhe nga vendet anëtare të lindjes që varen nga thëngjilli. Një zyrtar i BE-së i ka thënë agjencisë së lajmeve "Reuters" se suksesi i propozimeve të reja do të varet nga aftësia që ato të jenë realiste dhe të drejta në aspektin social dhe jo ta destabilizojë ekonominë. "Qëllimi është që ekonomia të vendoset në tjetër nivel, jo të ndalet", është cituar të ketë thënë ai.

Mbi 70 njerëz të vdekur nga dhuna në Afrikë të Jugut

PRETORIA, 14 KORRIK - Numri i viktimave nga dhuna në Afrikën e Jugut arriti në 72, thanë autoritetet. Dhuna shpërtheu qëkur ish-presidenti i këtij vendi, Jacob Zuma, u dorëzua në polici javën e kaluar. Turmat që plaçkitin dhe djegin dyqane vazhdojnë të përleshin me policinë në disa qytete. Në ndihmë të policisë tani ka dalë edhe ushtria. Autoritetet e rendit thanë se kanë identifikuar 12 persona të dyshuar për provokimin e trazirave dhe se mbi 1 200 vetë tashmë janë arrestuar. Disa ministra paralajmëruan se nëse plaçkitjet vazhdojnë, ka rrezik që disa zona të mbeten pa artikuj ushqimorë, por e përjashtuan shpalljen e

gjendjes së jashtëzakonshme. Zuma, 79 vjeç, është dënuar për shpërfillje të gjykatës muajin e kaluar, pasi nuk ka marrë pjesë në një hetim për korrupsion gjatë presidencës së tij. Zuma, i cili e mohon korrupsionin, është dënuar me 15 muaj burgim. Ai është dorëzuar në polici të mërkurën e kaluar. Disa zyrtarë thonë se disa grupe po përfitojnë nga zemërimi për burgosjen e Zumës, për të kryer veprime kriminale ndërsa, sipas të tjerëve, zemërimi për papunësinë dhe varfërinë po nxit kaosin. Presidenti aktual i Afrikës së Jugut, Cyril Ramaphosa, tha se dhuna është nga më të rëndat në këtë vend, që nga vitet 1990, përpara se të përfundonte



apartheidi. Dhuna është e përqendruar në

provincat KwaZulu-Natal dhe Gauteng, me zjarrvënie,

bllokim rrugësh dhe plaçkitje biznesesh.

Arrestohet drejtori i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë në Bosnje



SARAJEVË, 14 KORRIK - Drejtori i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë në Bosnje dhe Hercegovinë, Osman Mehmedagiq, u arrestua të mërkurën, konfirmoi Ministria e Punëve të Brendshme e Kantonit të Sarajevës. Prokuroria e Bosnjës tha se i dyshuari Osman

Mehmedagiq u privua nga liria me urdhër të saj, raporton Shërbimi i Ballkanit i "Radios Evropa e Lirë". Zyra e Prokurorit tha se Mehmedagiq dyshohet për veprat penale: keqpërdorim i pozitës ose autoritetit, falsifikim i dokumenteve dhe pastrim i parave. Pjesëtarë të Ministrisë së

Brendshme të Kantonit të Sarajevës kanë bastisur mjediset e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë në Bosnje qysh në fillim të korrikut. Bastisja është kryer me urdhër të Gjykatës së Bosnjës në kuadër të rastit të njohur si "Diploma". Në vitin 2019 Mehmedagiqit i është anuluar diploma e

vitit 2007 nga Fakulteti në Banja Llukë. Ai pastaj ka dorëzuar dy diploma nga Universiteti Amerikan dhe Fakulteti i Drejtësisë në Sarajevë. Prokuroria ka nisur hetimet, pasi Mehmedagiq nuk e ka përfshirë më herët diplomën e Universitetit Amerikan në biografinë e tij.

Edhe mosha mbi 18 vjeç në Kosovë mund të vaksinohet kundër Covidit

PRISHTINË, 14 KORRIK (ER) - Të gjithë qytetarët mbi 18 vjeç në Kosovë mund të regjistrohen dhe të vaksinohen kundër

koronavirusit. Ministria e Shëndetësisë ka bërë me dije se të interesuarit duhet të regjistrohen paraprakisht në platformën elektronike

eKosova. Kosova ka nisur vaksinimin kundër koronavirusit në fund të marsit. Fushata e imunizimit është


ndarë në tri faza. Në të parën u është dhënë përparësi punonjësve shëndetësorë dhe personave mbi 80 vjeç. Nga mesi i majit

është zhvilluar faza e dytë, që ka përfshirë personat e moshës 65 deri në 79 vjeç, ndërsa më 15 qershor ka nisur vaksinimi masiv.

Edhe dymbëdhjetë raste të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 14 KORRIK (ER) - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë (IKShPK) ka regjistruar të mërkurën 12 raste të infektimit me Covid-19 pas testimit të 1 421 mostrave. Gjatë 24 orëve të fundit nuk është regjistruar asnjë viktimë. IKShPK-ja ka njoftuar se më 14 korrik janë shëruar 14 pacientë nga sëmundja Covid-19, ndërsa raste aktive janë 106. Prej 13 marsit 2020, kur janë regjistruar rastet e para të infektimit, autoritetet shëndetësore në Kosovë kanë

regjistruar 107 879 pacientë me këtë virus. Prej këtyre, 2 264 kanë vdekur. Në Kosovë tashmë ka nisur programi i vaksinimit masiv kundër koronavirusit. Në këtë vend ka vaksina të prodhuesve Pfizer/BioNTech dhe AstraZeneca. Në 24 orët e fundit ndonjëri nga këto vaksina e kanë marrë 11 518 persona. Numri i personave të vaksinuar me të dyja dozat e vaksinave ka shkuar në 78 298, ndërsa shifra totale e vaksinave të dhëna është 282 180.



Vuçiqi: Nuk di nëse do të ketë përparim në dialogun me Kosovën

PRISHTINË, 14 KORRIK - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka thënë se delegacioni i Serbisë shkon me "besimin më të madh" në Bruksel, ku më 19 korrik do të mbahet raundi i radhës i bisedimeve për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi. "Duam të bisedojmë, t'i zgjidhim problemet konkrete nga

personat e zhdukur e gjithëka tjetër. Mendoj se përparimi është i nevojshëm, por nëse është i mundur, do ta shohim", ka deklaruar Vuçiq. Një ditë më herët Bashkimi Evropian si ndërmjetësues i dialogut ka konfirmuar se raundi i ri i bisedimeve në nivelin më të lartë politik do të mbahet më 19 korrik. "Ky takim

i nivelit të lartë do të përqendrohet në diskutimet për përparimin e bërë, për hapat e ardhshëm në dialog, i cili është i rëndësishëm për perspektivën evropiane të Kosovës dhe Serbisë", ka thënë zëdhënësi i BE-së, Peter Stano. Takimi do të jetë i dyti midis kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit të Serbisë,

Aleksandar Vuçiq. Në takimin e 15 qershorit dy zyrtarët nuk janë pajtuar për asgjë, por kanë rënë dakord t'i vazhdojnë takimet. Mosmarrëveshjet midis tyre kanë të bëjnë sidomos me formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. Kurti ka thënë më herët se në Kosovë nuk mund të ketë asociacion njëetnik. Pala serbe këmbëngul që Kosova

duhet ta zbatojë marrëveshjen për Asociacionin. Pala e Kosovës, në anën tjetër, thotë se ka një numër marrëveshesh të arritura në dialog, që pala serbe nuk i zbaton në mënyrë të duhur, përfshirë, sipas saj, marrëveshjen për kontrollin e kufirit, njohjen e diplomave, lirinë e lëvizjes e të tjera.



Qeveria emëron Andin Hotin kryetar të Delegacionit të Kosovës për bisedime për personat e zhdukur

PRISHTINË, 14 KORRIK (ER) - Qeveria e Kosovës të mërkurën ka marrë vendim që djalin e veprimtarit Ukshin Hoti, Andin Hoti, ta

emërojë kryetar të delegacionit të Kosovës për bisedime për çështjen e personave të zhdukur në kuadër të Grupit Punues për

Persona të Zhdukur. Andin Hoti, i cili në legjislaturat e kaluara ka qenë deputet i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), para pak

ditësh është emëruar nga kryeministri Albin Kurti kryesues i Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur.





INSTITUCIONET QENDRORE MOBILIZOHEN PËR T'I DALË NË NDIHMË KOMUNËS SË DEÇANIT

Ende nuk dihen shkaqet e helmimit në Deçan

- Disa mostra të helmimeve në Deçan do të testohen jashtë Kosovës

Kanë kaluar katër ditë nga raportimi i rasteve të para të helmimit të qytetarëve në Deçan, por ende nuk dihet shkaktari i helmimit. Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka bërë me dije se disa mostra të ujit do të dërgohen për analiza të mëtejshme jashtë vendit. Derisa institucionet po bëjnë përpjekje për ta gjetur shakatarin e helmimit, qytetarët e Deçanit edhe të mërkurën kanë vazhduar të kërkojnë ndihmë mjekësore. Sipas autoriteteve lokale, vetëm në 24 orët e fundit qindra persona kanë kërkuar ndihmë mjekësore

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 14 KORRIK - Fluksi i qytetarëve të Deçanit për të kërkuar ndihmë mjekësore nga helmimi ka vazhduar edhe në 24 orët e fundit. Ndonëse kanë kaluar katër ditë nga shfaqja e helmimeve të para, ende nuk dihet shkaku i helmimit nga i cili deri më tani janë prekur mbi 1 500 qytetarë të kësaj komune. Institucionet kanë bërë me dije se janë duke bërë maksimumin për gjetjen e shkaktarit kryesor të helmimit.

Ministri i Shëndetësisë në Kosovë, Arben Vitia, ka bërë me dije të mërkurën se është marrë vendim

për të kryer analiza shtesë të disa mostrave të pacientëve të helmuar ditë më parë në Deçan. Gjatë mbledhjes së qeverisë ai ka thënë se duhen analiza specifike për ta gjetur shkaktarin e helmimit. "Sot janë përgatitur edhe një numër mostrash të cilat shumë shpejt priten të dërgohen jashtë vendit për analiza më specifike, të cilat nuk mund të kryhen në Kosovë", ka thënë Vitia. Sipas tij, situata tani është më e qetë dhe ka më pak fluks të pacientëve që po kërkojnë ndihmë.

Kurse zëvendëskryeministri i parë i Kosovës, Besnik Bislimi, i cili në mungesë të kryeministrit Albin Kurti e ka udhëhequr mbledhjen e

qeverisë, ka thënë se qeveria dhe institucionet përgjegjëse kanë ndërmarrë disa veprime në lidhje me situatën e krijuar pas dyshimeve për helmim në Deçan. "Agjencia e menaxhimit të emergjencave i është ofruar me shërbime të furnizimit me ujë të pijshëm komunës së Deçanit dhe çdo gjë tjetër të nevojshme në fushën që mbulon agjencia dhe vazhdon të jetë në dispozicion nëse kjo kërkohet nga komuna e Deçanit", ka thënë Bislimi. Ai ka treguar kur është njoftuar qeveria për helmimet në Deçan. "Më 11 korrik, të dielën, Ministria e Shëndetësisë ka pranuar raportin nga IKShPK-ja për një numër të banorëve nga disa fshatra të

komunës së Deçanit që kanë kërkuar ndihmë mjekësore në QKMF në Deçan me ankesa shëndetësore që pas trajtimit janë udhëzuar për trajtim shtëpiak. Të gjitha hapat e nevojshëm në hulumtimin e burimit të helmimit janë ndërmarrë menjëherë të dielën në mëngjes. Gjatë fundjavës janë mobilizuar të gjitha ekipet që po vazhdojnë

punën në mënyrë aktive bashkë me ekipet e Prishtinës, Pejës, Prizrenit dhe Gjakovës. IKShPK-ja vazhdon hulumtimin në terren dhe grumbullimin e anketave epidemiologjike nga të prekurit dhe familjarët e tyre dhe raportin në vazhdimësi", ka thënë Bislimi, duke treguar për ndihma që i ka ndarë qeveria. "Kontingjenti i parë i barnave ka arritur dje në

Qeveria ndan 150 mijë euro për Deçanin

Qeveria e Kosovës ka ndarë 150 mijë euro për trajtimin dhe rregullimin e ujësllësit për fshatrat e Komunës së Deçanit. Në mbledhjen e qeverisë është thënë se një numër i mostrave të qytetarëve të helmuar në këtë komunë do të dërgohen jashtë vendit. Zëvendëskryeministri Besnik Bislimi, i cili ka drejtuar këtë mbledhje në mungesë të kryeministrit Albin Kurti, ka thënë

se të gjitha institucionet përgjegjëse janë mobilizuar për t'u dalë në ndihmë qytetarëve të Deçanit. Ndërsa ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka thënë se do ta procedojnë shumë shpejt kërkesën për ndarjen e mjeteve për Deçanin. "Kemi pasur kërkesë që të ndajmë mjete dhe besoj që shumë shpejt do ta procedojmë", ka thënë Murati.

Helmimi i qytetarëve në Deçan, Prokuroria nis hetimet

Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka njoftuar se tashmë kanë nisur hetimet pas helmimit të mbi 1 500 qytetarëve në Deçan. Sveçla në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës ka thënë se gjendja e sigurisë në Deçan është e qetë. “Policia e Kosovës ka qenë në dispozicion të menaxhimit të situatës. Prokuroria ka iniciuar raste të dyshimta të veprës penale ‘shkaktim i përgjithshëm i rrezikut’, po ashtu kanë nisur hetimet për dy vdekjet”, ka thënë Sveçla.

mbrëmje dhe materiale të tjera shpenzuese të domosdoshme për tejkalimin e situatës. MSh-ja është në kontakt të vazhdueshëm me institucionet shëndetësore atje për çdo nevojë shtesë”, ka thënë Bislimi.

Ramosaj: Jemi të interesuar që çështja e helmimit të sqarohet deri në fund

Kryetari i komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka deklaruar se numri i qytetarëve të Deçanit që kanë kërkuar ndihmë mjekësore nga helmimet deri me tani është mbi 1 500. Në një konferencë për media ai ka treguar se analizat kimike dhe biologjike që i ka bërë IKShPK-ja kanë treguar se uji është i pastër. Ramosaj ka thënë se është i interesuar që kjo çështje të sqarohet deri në fund. “Dje kemi marr analizat nga IKShPK-ja të cilat rezultojnë se uji i pijes në aspektin kimik dhe biologjik është i përdorshëm dhe është i pastër, mirëpo ende duhet të bëhen analiza shtesë për gjetjen e faktorëve dhe shkaqeve se pse ka ardhur gjithë ky infeksion. Ne jemi të interesuar që kjo çështje të trajtohet dhe të sqarohet deri në fund, sepse qytetarët e kësaj komune e kanë të drejtën të dinë se pse ka ndodhur kjo”, ka deklaruar Ramosaj.

Ai ka përmendur që në qershor të këtij viti autoritetet janë përballur me një rast të ngjashëm. “Ne kemi pasur një situatë të tillë në dhjetëditëshin e parë të muajit

qershor, me banorët e fshatit Krushevc, që është fshat i Pejës, por që furnizohet nga një burim i ujit që është nga Deçani. Kemi ftuar në takim Hidrodrinin dhe Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik dhe brenda ditës ata na kanë dhënë një analizë kimike që uji është në gjendje të rregullt, kurse më vonë kemi pranuar edhe analizën biologjike dhe na kanë raportuar që uji është 100 për qind në rregull”, ka thënë Ramosaj. Sipas tij, ky rast ka mbetur i izoluar, meqë më pas nuk ka pasur shqetësime të tjera, mirëpo ka rritur vëmendjen për situatën e krijuar këtë muaj. “Kjo gjë na bën që të jemi më të fokusuar dhe më të përkushtuar, që këto analiza të jenë më të detajuara, më të thella, që ta kuptojmë se a ka ndodhur kjo gjë nga uji”, ka deklaruar ai.

Më 13 korrik Deçani ka shpallur gjendje emergjente për shkak të helmimit masiv të banorëve të kësaj komune. Po të njëjtën ditë u sjellësi “Hidrodrini” ka njoftuar qytetarët që furnizohen me ujë nga ky ujesjellës rajonal, se uji është i sigurt. “Informatat dhe gjendja e paqartë me fshatrat e Deçanit përbëjnë shqetësim të lokalizuar në vete dhe, siç dihet, të gjithë mekanizmat janë në funksion të zgjidhjes së situatës atje, në shërbim të përmirësimit të shëndetit të qytetarëve”, ka thënë përmes një komunikate për media Ujesjellësi Rajonal “Hidrodrini”.

“Hidrodrini”, përveç Deçanit, furnizon me ujë edhe Pejën, Istogun, Klinën dhe Junikun.



Mbrojtja e Gucatit dhe Haradinajt: Jemi gati për gjyq pas 30 gushtit



HAGË, 14 KORRIK (ER) - Prokurori në çështjen për krerët e Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Hysni Gucati dhe Nasim Haradinajt, ka thënë se do të kërkojë masa mbrojtëse për dëshmitarët që do të sillen për akuzat ndaj të tyre për pengim të drejtësisë. Ai ka thënë se ka shumë dokumente të cilat janë kërkuar nga mbrojtja, por për të cilat nuk ka dashur të flasë më shumë.

Kështu u tha të mërkurën në konferencën e gjashtë mbi ecurinë e çështjes gjyqësore ndaj ish-krerëve të Organizatës së Veteranëve të Luftës, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj. “Do të bëjmë kërkesa me kohë në lidhje me masa mbrojtëse për dëshmitarët tanë dhe do ta bëjmë kërkesën në kohën e duhur përpara trupit gjykues. Në lidhje me nxjerrjen e dokumenteve ka shumë

dokumente të kërkuara nga mbrojtja, që në këtë moment nuk duam të nxjerrim informacione të tjera. Ka një kërkesë të pazgjidhur ende të palës së tretë që nuk është përgjigjur ende. Presim ta bëjmë në fund të korrikut. Nuk besojmë se do të kërkojmë redaktime, por varem nga palët e tjera të jashtme”, ka thënë ai në lidhje me materialet e deritanishme të çështjes. Ndërsa mbrojtja e Gucatit dhe e Haradinajt thanë se parashohin që të ketë vështirësi për nxjerrjen e materialeve por, sipas saj, nuk do të ketë vonesa në transferimin e dosjes para trupit gjykues.

Avokati i Hysni Gucati dhe ai i Nasim Haradinajt kanë thënë se kanë kryer shumë hetime deri më tani, mirëpo u nevojitet të ndjekin edhe disa linja hetimi, duke përfshirë këtu edhe intervistimin e disa personave në Kosovë dhe Serbi.

Avokat i Hysni Gucati, Jonathan Rees, ka thënë se do të ishin gati për gjyq pak kohë pas 30 gushtit. “Kemi dhënë një listë të dëshmitarëve të cilët kërkojmë që t’i ftojme, ku përcaktojmë identitetet e tyre dhe sipas temave tregojmë se për çfarë çështje do të dëshmojnë ata. Shpresojmë që një kërkesë e tillë, që kur çështja t’i paraqitet trupit gjykues, do të ketë seanca të mëtejshme për përgatitje ku do t’u kthehemi sërish këtyre çështjeve. Ka disa fusha ku mund të ketë nevojë të vazhdojnë hetimet. Nuk parashikojmë që kjo t’i vonojë çështjet më tej. Do të ishim gati për gjyq pak kohë pas 30 gushtit dhe kemi arritur këtu ku kemi thënë që do të ishim”, ka thënë Rees.

Në shtator të vitit të kaluar janë arrestuar dy ish-krerët e OVLUÇK-së, kryetari Hysni Gucati dhe nënkryetari i kësaj organizate, Nasim Haradinaj.

Nga sot Gucati dhe Haradinaj mund të takohen me familjarët e tyre

Zyrtari nga Zyra e Administrimit të Dhomave të Specializuara ka njoftuar se nga 1 korriku ish-krerët e Organizatës së Veteranëve të Luftës, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj, mund të takohen me avokatët e tyre pa ndarje me qelq. “Gjatë gjithë pandemisë ne kemi punuar nga afër me personelin mjekësor në objektin e paraburgimit. Dhe mund t’ju them se duke filluar nga data 1 korrik vizitat mund të bëhen në objektin e paraburgimit, edhe pa

ndarje, dmth. pa ndarje me qelq. Kjo vlen për të gjithë avokatët që janë të vaksinuar plotësisht dhe që vijnë nga vende në zonën e gjelbër dhe të verdhë. Duke filluar nga data 16 korrik ky relaksim për popullsinë në Holandë është zbatuar së bashku me një sërë masash të tjera, gjithashtu kemi marrë masa për t’u dhënë mundësi avokatëve që jo vetëm të shihen me ta përmes ekraneve, por edhe të takohen fizikisht”, ka njoftuar Zyra e Administrimit. Zyrtari nga Zyra e Administrimit

ka pohuar se nga 15 korriku mund të fillojnë edhe vizitat e familjarëve nga afër. “Sa iu takon vizitave të familjeve, duke ndjekur nga afër këshillat mjekësore, vizitat e familjeve nga afër, mund të fillojnë që nesër dhe janë planifikuar ose pritet që të zhvillohen, pra edhe një herë e përsëris që janë të mundshme vizitat e familjarëve nga afër”, ka thënë ai. Avokatët e Gucatit dhe të Haradinajt thanë se kanë mirëpritur këtë vendim.

Policia identifikon dymbëdhjetë vetura me regjistrim të skaduar

MITROVICË, 14 KORRIK (ER) - Në mbështetje dhe zbatim të planeve operative "Sezoni veror" 2021, zyrtarët policorë të Njësisë së Reagimit të Shpejtë në kuadër të Drejtorisë Rajonale të

Policisë në Mitrovicën e Jugut, gjatë natës së kaluar kanë ndaluar dhe identifikuar 29 raste të kundërvajtjeve të ndryshme në trafik. Kundërvajtësve u janë shqiptuar gjoja, ndër to

janë identifikuar dymbëdhjetë automjete në qarkullim me regjistrim të skaduar, me ç'rast u janë sekuestruar targat dhe automjetet janë larguar nga trafiku rrugor.



KEDS-i do të investojë rreth 7.5 milionë euro në rrjetin elektrik të Gjakovës



GJAKOVË, 14 KORRIK (ER) - Ushtruesi i detyrës i drejtorit të investimeve në KEDS, Faruk Gjukaj, i shoqëruar nga këshilltari ekzekutiv Avni Alidemaj dhe inxhinierja për bashkëpunim me institucione qeveritare, Burbuqe Baruti, janë pritur të mërkurën në takim nga kryetari i komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, me bashkëpunëtorë. Gjatë këtij takimi është diskutuar rreth bashkëpunimit aktual në mes të KEDS-it dhe komunës së

Gjakovës. Ushtruesi i detyrës i drejtorit të investimeve në KEDS, Faruk Gjukaj, ka bërë me dije se në rrjetin elektrik të Gjakovës do të investojnë rreth 7.5 milionë euro. "KEDS-i ka planifikuar që në Komunën e Gjakovës të realizojë projekte madhore investive në rrjetin elektrik. Kostoja e tyre do të jetë rreth 7.5 milionë euro. Këto investime do të ofrojnë zgjidhje afatgjatë për konsumatorët tanë atje", ka thënë Gjukaj. Ndërsa kryetari i komunës së

Gjakovës, Ardian Gjini, ka shprehur mirënjohjen e tij për këtë mbështetje që KEDS-i është duke ia ofruar kësaj komune. "Ne jemi të hapur që ta shtojmë bashkëpunimin. Ne do të shtojmë përpara çdo proces teknik që na takon si komunë në mënyrë që sa më parë të fillojë operacionalizimi dhe implementimi i projekteve. Sigurisht se me këto investime të KEDS-it, rrjetit elektrik po i bëhet një zgjidhje e mirë", ka thënë Gjini.

Mbahet dëgjimi i fundit buxhetor me përfaqësuesit e fshatrave të Luginës së Ibrit

Mitrovicë, 14 korrik (ER) - Pas shtatë dëgjimeve publike që janë mbajtur në Komunën e Mitrovicës, Drejtoria për Financa dhe Zhvillim Ekonomik ka mbajtur të mërkurën dëgjimin e tetë me qytetarë, i cili, sipas kësaj drejtorie, është i fundit për planifikimin e buxhetit për vitin 2022-2024.

Drejtori për Financa dhe Zhvillim Ekonomik, Shukri Gashi, ka thënë se qëllimi i

këtyre dëgjimeve është që të bashkëbisedojnë me qytetarët për të bërë një buxhet më të mirë që është në interes të qytetarëve.

Ndërkaq në fjalën e tij zyrtari kryesor financiar, Adem Fazliu, ka shpalosur buxhetin e komunës së Mitrovicës për vitin 2022 i cili planifikohet të jetë 21,526,713.00 euro dhe granti i përgjithshëm do të jetë në shumën prej 7,357,0710,00 eurosh. Gjatë takimit qytetarët

kanë bërë propozime dhe kërkesa konkrete për nevojat në investime, qoftë në infrastrukturë apo edhe në subvencionime, për t'u përfshirë në planifikimin e buxhetit të vitit 2022.

Drejtorët komunalë kanë regjistruar kërkesat e qytetarëve dhe kanë dhënë sqarime për mundësinë e përfshirjes së projekteve të propozuara në buxhetin e komunës për vitin 2022.



Komuna e Podujevës dhe MAPL-ja arrijnë marrëveshje për financimin e projektit "Ndërtimi i kolektorit të ujërave atmosferike"



PODUJEVË, 14 KORRIK (ER) - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka nënshkruar të mërkurën marrëveshje bashkëpunimi me ministrin e MAPL-së, Elbert Krasniqi, për financimin e projektit "Ndërtimi i kolektorit të ujërave atmosferike". Vlera

totale e këtij projekti është rreth 148 mijë euro, prej tyre nga buxheti i komunës janë ndarë 100 mijë, ndërsa nga MAPL-ja 48 mijë euro. Bazuar në marrëveshjen e nënshkruar, komuna zhvillon të gjitha procedurat, sipas legjislacionit në fuqi dhe kujdeset që ky

projekt të përfundojë brenda vitit buxhetor 2021. Kryetari Bulliqi ka falënderuar ministrin Krasniqi për bashkëpunimin dhe ka shprehur gatishmërinë e komunës për bashkëpunim edhe për realizimin e projekteve të tjera në interes të qytetarëve.

Vazhdon inspektimi në marketet ushqimore në Malishevë

MALISHEVË, 14 KORRIK (ER) - Komuna e Malishevës ka njoftuar se është duke vazhduar inspektimi në marketet ushqimore në gjithë territorin e kësaj komune. Në njoftimin për media të komunës së Malishevës theksohet se inspektorët komunalë janë në aksion të përhershëm për

kontrollin e gjërave ushqimore me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve gjatë blerjes së produkteve ushqimore dhe konsumit të ushqimit të sigurt. Sipas drejtorit të Drejtorisë së Inspektoratit, Dibran Kastrati, inspektorët janë në inspektim të marketeve për kontrollin e produkteve me afat të skaduar

dhe produkteve të dëmtuara, sidomos në këtë periudhë kur konsumi është më i madh, në prag të festës së Bajramit dhe ardhjes së mërgimtarëve. Ai ka njoftuar se të gjitha produktet ushqimore në treg janë të sigurta dhe për një gjë të tillë janë duke u përkujdesur vazhdimisht.



PSD-ja: Parimet e Kurtit i mori era

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 14 KORRIK - Partia Socialdemokrate (SD) ka organizuar të mërkurën një aktivitet para objektit të Qeverisë së Kosovës për ta kundërshtuar qeverisjen e kryeministrit Albin Kurti. Kjo parti ka lëshuar disa balonë në ajër me premtimet e Kurtit, për të cilat ka thënë se i shërbyen për ta marrë pushtetin. "Negociatat kanë rifilluar pas sa kohësh aty ku kanë mbetur. Për më

tepër, Besnik Bislimi pranon se janë pajtuar me të gjitha marrëveshjet, përveç atë për targat KS. Ajo çka dallohet nga ky proces është tentimi për ndërrim të terminologjisë, ndërrim të tonit dhe të ritmit, por jo edhe të procesit sepse, në të kundërtën, do të kishim dëgjuar për një projekt alternativ si propozim i KM. Kurti. Në vend të një përpjekjeje politike për përmbylljen e çështjes me Serbinë dhe hapjen e mundësive të reja të zhvillimit, kemi bunkerizim të pushtetit të ri. Aty-këtu dëgjohe

intervista të rralla dhe të kontrolluara mirë. Ndërrimi i gjuhës me të cilin akomodohen marrëveshjet e vjetra, tentojnë amortizim të pakënaqësisë, krijim të hutisë. E kush ka nevojë për qartësi e njohuri kur në ballë prinë një politikan që e sheh veten si bartës të fatit të historisë? E për këtë shërbim ndaj qytetarëve, ai kërkon besim të verbër. Regjimi i tij do dëgjueshmëri", është theksuar në mesazhin e PSD-së.

Sipas kësaj partie, nga prioriteti i shtatë, dialogun e ngriti në të tretin

e të dytin, e shumë shpejt u bë i pari. "E për këtë nuk dha llogari. Regjimi i Kurtit, përveç që është i mbyllur sa i përket ecurisë për dialogun, ai po e bunkerizon Kosovën përmes përjetësimit të problemit me Serbinë. Me ose pa Asociacion, ruajtja e pushtetit është qëllimi i tij. Gjuha në njërin anë, mungesa e transparencës në anën tjetër, janë shenja që duhen lexuar. Përmes bashkimit të këtyre pikave vizatohet problemi. Figura del e duket. Për projekt që zgjidh problemin me Serbinë, duhet

guxim. E Kurti e ka karakteristikën e liderëve autoritarë: ata janë frikacakë. Por sado i madh të jetë pushteti i Kurtit, qëndrimet e dikurshme nuk i fsheh dot. Ai premtoi që duhet: dialog me serbët lokalë, rishikim të marrëveshjeve, kërkimfalje nga Serbia, reciprocitet, dialog të hapur dhe demokratik, refuzim të Asociacionit, kërkesë për riparimin e dëmeve të luftës, nevojën e njohjes e kështu me radhë. Por parimet e tij për dialogun i mori era", thuhet në njoftimin e PSD-së.



Ahmeti: Qendra e Mjekësisë Familjare në Veternik do të finalizohet deri në fund të këtij viti

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 KORRIK - Kryetari i komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, së bashku me drejtorin e Shëndetësisë, Bujar Gashi, kanë vizituar të mërkurën vendpunishten në rrugën "Kujtim Laro" të lagjes Veternik, ku po ndërtohet qendra e parë e Mjekësisë Familjare për këtë zonë.

Shpend Ahmeti me rastin e vizitës në vendpunishte ka bërë me dije se kjo Qendër e Mjekësisë Familjare do të ofrojë të gjitha shërbimet sikurse qendrat e tjera në kryeqytet dhe pritet të finalizohet deri në fund të këtij viti, duke zgjeruar rrjetin e qendrave që ofrojnë shërbime publike shëndetësore në



Prishtinë. "Me këtë qendër zgjerohet rrjeti i shërbimeve shëndetësore publike në Prishtinën e re. Qendra pritet të përfundojë deri në fund të vitit si dhe do t'i mbulojë të gjitha shërbimet që përfshinë mjekësia familjare përfshirë laboratorin

dhe biokiminë", ka thënë Ahmeti. Ai ka theksuar se investimet në shëndetësinë publike gjatë dy mandateve të qeverisjes kanë reformuar sistemin dhe garantuar qasje më të madhe të qytetarëve të Prishtinës në shërbime publike shëndetësore, që janë esenciale

për qytetarët. "Jemi konkurrues edhe me sektorin privat. Ofrojmë të gjitha shërbimet dhe jemi komuna e vetme që ofrojmë një gamë të testeve edhe laboratorike, shumë shpesh duke mbuluar edhe hapësirat që kalon Ministria e Shëndetësisë. Së fundmi e kemi pasur edhe mungesën e insulinës e cila është pjesë e listës së barnave esenciale dhe që është jetike me që diabeti nuk pret dhe është dashur që t'i prokurojmë vetë. Po e them se jam i lumtur sepse shëndetësia publike dhe shëndeti publik është kryesor dhe ne kemi investuar në këtë drejtim. Njerëzit që kanë para kërkojnë shërbime në sektorin privat dhe i marrin shërbimet, por ajo është pjesa më e vogël e popullatës, ndërsa pjesa më e madhe e popullatës bazohet në shëndetësi publike. Përderisa në

mandatin e parë kemi punuar më tepër në infrastrukturën fizike, unë mendoj që testi kryesor për ne ka qenë pandemia kur e kemi parë që në shumicën e rasteve jo që nuk kemi dështuar, por po e them u kemi ofruar edhe shërbime të tjera qoftë me infuzione në laborator që njerëzit me Covid mos të shkojnë në QKUK, e deri te testet serologjike pa pagesë", ka thënë Ahmeti. Qendra e Mjekësisë Familjare në zonën perëndimore në lagjen Veternik është projekt i financuar nga Komuna e Prishtinës dhe ka qenë i gatshëm që nga viti 2019. Projekti arrin vlerën e 463 318 eurove. Kjo qendër do t'u shërbejë rreth 20 mijë banorëve të lagjes Veternik, me ç'rast do të lehtësohet qasja e tyre në shërbimet shëndetësore.

Myftiu Tërnavë viziton Konjufcën

PRISHTINË, 14 KORRIK (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të mërkurën në takim kryetarin e

Bashkësisë Islame të Kosovës, myftiun Naim Tërnavë. Ky i fundit e ka përgëzuar Konjufcën për detyrën e re, duke shprehur

gatishmërinë për bashkëpunim e mbështetje. Konjufca e ka falënderuar myftiun Tërnavë për bashkëpunimin e

ndërsjellë, duke vlerësuar sidomos kontributin e tij dhe të BIK-ut për parandalimin e përhapjes së Covid-19.



Qeveria miraton pakon për ringjallje ekonomike në vlerë prej 423 milionë eurosh

PRISHTINË, 14 KORRIK - Qeveria e Kosovës në mbledhjen që ka mbajtur të mërkurën ka miratuar pakon për ringjallje

ekonomike në vlerë prej 423 milionë eurosh. Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati,

ka treguar se kjo pako përbëhet nga pesë grupe të masave ku një prej tyre është mbështetja e punësimit në vlerë prej 50

milionë eurosh. "Përmes kësaj pakoje synohet rritja dhe zhvillimi ekonomik i vendit", është shprehur Murati.



Komisioni për Buxhet voton raportin për Projektligjin për automjete

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 14 KORRIK (ER) - Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, i kryesuar nga kryetari Armend Muja, ka mbajtur të mërkurën mbledhjen e radhës. Në fillim të mbledhjes kryetari Muja ka propozuar që të hyjë si pikë e rendit të ditës raporti me amendamente për Projektligjin nr. 08/L-004 për

ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 05/L-132 për Automjete, me rekomandim të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis, Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë.

Raporti u miratua me shumicën e votave të anëtarëve të komisionit. Po me propozimin e kryetarit Muja, raporti vjetor financiar i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë për vitin 2020 u vendos që të

shqyrtohet në njërin nga mbledhjet e ardhshme, në mënyrë që anëtarëve të Këshillit që sapo janë emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës t'u jepet kohë për ta paraqitur raportin.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan që shqyrtimi i raportit vjetor i Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për vitin 2020 që ishte paraparë për mbledhjen e sotme, të shtyhet, pasi që në

mungesë të drejtorit të kësaj Agjencie, përfaqësimi, sipas deputetëve, nuk ishte adekuat. Mbledhja ka vazhduar me shqyrtimin e raportit vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2020, të cilin raport e paraqiti anëtari i Bordit të ZRRE-së, Izet Rushiti. Pas raportimit u hap debati për pyetje nga ana e deputetëve, e që morën përgjigje nga ana e përfaqësuesve të ZRRE-së. Pas

debatit raporti u hodh në votim, por nuk mori miratimin e komisionit. Komisioni ka shqyrtuar edhe raportin vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) për vitin 2020 të cilin e ka paraqitur Osman Vishaj. Për votimin e tij nuk pati kuorum, sikurse as për shqyrtimin e raportit vjetor financiar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2020.



ATK-ja, e para në raportin e OECD-së mbi konkurrencën në Evropën Juglindore



PRISHTINË, 14 KORRIK (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) është vlerësuar më së miri në raportin e OECD-së mbi konkurrencën në Evropën Juglindore 2021. Sipas njoftimit për media, ATK-ja është vlerësuar në fushat: tiparet, funksionet dhe organizata, në vlerësimin e përbushjes dhe menaxhimin e rrezikut, pavarësinë dhe transparencën, deklarimin tatimor dhe procedurat e pagesës, shërbimet ndaj tatimpaguesve.

Në këtë raport përfshihen gjashtë vende të Evropës Juglindore si: Shqipëria, Bosnjë dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut, Kosova, Mali i Zi dhe Serbia. Raporti vlerëson në mënyrë gjithëpërfshirëse reformat e politikave në ekonomitë e Evropës Juglindore. Ky raport synon t'u ofrojë politikë bërësve të Evropës Juglindore një mjet krahasimi shumëdimensional, duke u mundësuar atyre të krahasojnë performancën ndaj kolegëve

rajonalë si dhe praktikave e mira të OECD dhe t'i hartojnë politikat e ardhshme bazuar në prova të pasura dhe rekomandime të veprimit të politikave.

Po në këtë raport ATK-ja vlerësohet lart për zbatimin e funksionit të hetimit të mashtrimeve tatimore, mbikëqyrjen e vlerësimit të përbushjes tatimore dhe menaxhimin e rrezikut dhe avancimin e shërbimeve elektronike.

Zgjatet orari i gastronomisë dhe sallave të dasmave

PRISHTINË, 14 KORRIK (ER) - Oda e Hotelarisë dhe Turizmit e Kosovës (OHTK) ka njoftuar se nga dita e mërkurë është zgjatuar orari i organizimeve të

dasmave, ahengejeve të ndryshme dhe klubeve të natës. Sipas OHTK-së, këto biznese do të punojnë deri në orën 01:00 pas mesnate. Po

ashtu, numri i të ftuarve në hapësirat e mbyllura do të jetë deri në 300 persona. "Zgjatja e orarit do të bëhet deri në orën 01:00 pas mesnate dhe numri i

të ftuarve në hapësirat e mbyllura do të jetë deri në 300 persona. Ky vendim pritet të hyjë në fuqi nga dita e mërkurë", ka njoftuar OHTK-ja.





Korrupsioni në Ballkan është 'miku besnik' i Ruisë

Nga Stephen BLANK
"Center for European Policy
Analysis"

Ballkani mbetet skena kryesore në betejën shumëplanëshe të Ruisë kundër Evropës. Serbia është pa dyshim objektivi kryesor i këtij rivaliteti për shkak të madhësisë, vendndodhjes dhe historisë së saj. Që të gjitha këto e bëjnë atë elementin qendror strategjik të Ballkanit.

Moska ka nxitur grushte shteti në Ballkan, ka filluar një luftë masive të informacionit kundër Bashkimit Evropian dhe NATO-s, ka krijuar leva të qëndrueshme ndikimi me mediat e rajonit, ka synuar sistematikisht kontrollin e linjave energjitike të rajonit, duke fshehur korrupsionin zyrtar të shumë-përhapur, duke përhapur narrativat historiko-fetare të rreme në të gjithë rajonin, dhe po punon për ta projektuar fuqinë e vet ushtarake atje.

Ajo e ka bërë këtë duke kërkuar ndërtimin e një baze ushtarake në Maline Zi, duke kërcënuar rregullisht platformat energjetike rumune në Detin e Zi, dhe duke ndërtuar një të ashtuquajtur qendër humanitare në Nish të Serbisë (edhe pse pavarësisht presionit rus, Beogradi ka refuzuar me të drejtë t'i japë kësaj qendre statusin diplomatik).

Në këtë përplasje të pafundme, korrupsioni i përhapur i zyrtarëve në Ballkan, mbetet një nga "armët" më të testuara dhe të vërteta në arsenalin e Ruisë. Në sektorin e mbrojtjes,

korrupsioni zyrtar minon perspektivat e bashkëpunimit me Shtetet e Bashkuara, duke i tunduar zyrtarët që të arrijnë marrëveshje të errëta me Ruisë apo aktorët e tjerë dashakeq, si për shembull terroristët, duke i bërë ata të prekshëm ndaj shantazheve ruse.

Po ashtu ata i pengon bashkëpunimin me SHBA-në, pasi krijon varësi nga armët ruse, të cilat shërbejnë shpesh si një mjet për nënshtrimin ndaj Kremlinit të ushtrisë dhe qeverisë në këto vende. Raportet e fundit tregojnë se ka arsye të forta për t'u shqetësuar, duke pasur parasysh faktin se Ministri serb i Mbrojtjes i Serbisë, Nebojša Stefanović dhe familja e tij, janë përfshirë në akte të mundshme korruptive.

Në mënyrë të veçantë, agjencitë qeveritare serbe kanë zbuluar se babai i Stefanović bleu armë me çmime preferenciale nga prodhuesi shtetëror rus i armëve, Krusik, dhe më pas i shiti me çmime të larta, duke siguruar një licencë për eksportin e armëve në kohën kur djali i tij ishte Ministër i Brendshëm. Ndërkohë babai i ministrit pretendohet se i eksportoi këto armë në SHBA, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Arabinë Saudite, ndërsa disa prej tyre përfunduan në duart e islamikëve radikalë në Jemen. Aktualisht, Serbia po negocion me BE-në anëtarësimin në këtë organizatë.

Por bisedimet po ecin shumë ngadalë, sidomos për shkak të mbështetjes ruse ndaj opozitës

serbe, e cila refuzon lidhjet më të forta me Perëndimin. Nëse Serbia do të lëvizte në mënyrë të vendosur në kampin e demokracive perëndimore, atëherë të gjitha shtetet e Ballkanit do të lëviznin drejt anëtarësimin në BE dhe NATO, dhe integrimi i Evropës përgjatë vijave demokratike do të çonte drejt një hapi të madh përpara.

Skandali Stefanović tregon se nëse Serbia dëshiron vërtet që t'i afrohet BE-së dhe NATO-s, duhet të spastrojë nga të korruptuarit Ministrinë e saj të Mbrojtjes. Këto raporte sugjerojnë gjithashtu se udhëheqësit serbë, janë gjithnjë e më të gatshëm të heqin dorë nga mbështetësi i tyre i dikurshëm.

Në raporte të tilla të vërteta, SHBA-ja dhe BE-ja duhet që ta inkurajojnë një veprim të tillë, në mënyrë që të lehtësojnë afrimin me Serbinë. Rusia është e vendosur që të diskreditojë demokracinë dhe ta ndalë integrimin evropian.

Një Evropë e integruar demokratike, e plotë dhe e lirë, ka qenë prej kohësh makthi i Kremlinit, për shkak të pasojave që mund të sjellë për stabilitetin e kleptokracisë së Vladimir Putinit. Sergei Ivanov, ish-Ministër i Mbrojtjes dhe shefi i kabinetit të presidentit rus Putin, deklaroi për "Financial Times" se demokracia ishte një "bardak", pra një bordello kaotike. Por në të njëjtën kohë, një diplomat serb më tha vite më parë se shumë zyrtarë në qeverinë serbe do t'i mirëprisnin lidhjet më të ngushta me Shtetet e Bashkuara dhe NATO-n.

Në fakt, bashkëpunimi NATO-Serbi dhe SHBA-Serbi është më i fortë se sa mund të shihet në pamje të parë. Por këto lidhje mbeten të panjohura për publikun e gjerë, edhe për shkak të luftës së fortë informative të Ruisë kundër SHBA-së dhe NATO-s, dhe fshehjes së përfitimeve të një bashkëpunimi më të madh me Perëndimin.

Kjo fushatë është një pengesë e madhe e Ruisë për pasjen e marrëdhënieve më të ngushta SHBA-Serbi. Ajo i fryn zemërimin mbi ngjarjet e dikurshme, si fushata ajrore e NATO-s kundër Serbisë në vitin 1999, duke injoruar përfitimet nga zhvillimi demokratik për popullin e Serbisë 2 dekadat e fundit. Korrupsioni zyrtarëve të lartë i shërben po aq mirë komprometimit të politikën serbe, mbajtjes ndezur të konflikteve ballkanike, sidomos mosmarrëveshjes Serbi-Kosovë, dhe e lejon Ruisë që të vazhdojë aktivitetet e saj destabilizuese në të gjithë rajonin.

SHBA-ja dhe BE-ja mund të bëjnë më shumë për të promovuar përmirësimin e qeverisjes Serbe, dhe për të pasur lidhje më të ngushta me të. Presidenti Joe Biden, që e njeh mirë Ballkanin, duhet ta pranojë ftesën e Aleksandar Vučić për të vizituar Serbinë, dhe kur të shkojë atje ta bëjë të qartë se një sektor i korruptuar i mbrojtjes po e mban Serbinë larg aspiratave të saj evropiane.

Biden duhet t'i shesë Serbisë, ashtu si kompanitë evropiane, armët e nevojshme për të përmirësuar

ushtarinë dhe për ta pasur atë në standardet e kërkuara nga NATO, dhe për të zvogëluar ndikimin rus atje.

Gjeste të tilla do të shtonin përfitimet e publikut serb nga lidhjet me NATO. Aktualisht opinioni publik e vlerëson bashkëpunimin me NATO-n, por kundërshton fuqimisht anëtarësimin në këtë aleancë.

Nga ana tjetër, këto gjeste do të forconin pozitën e mbështetësve të integritetit me Perëndimin, të cilët më pas mund t'i ofrojnë qytetarëve prova të prekshme të përfitimeve nga ky integrim. Nga ana tjetër, kjo mund të inkurajojë emërimin e njerëzve të rinj në Ministrinë e Mbrojtjes dhe gjetkë, për të promovuar një cikël të vërtetshëm të qeverisjes së përmirësuar dhe të nxisë simpatinë për BE-në dhe NATO-n.

Ekspertët e dinë se strategjia e zakonshme e Perëndimit me rajonin nuk do të funksionojë më. Kjo vlen si për Beogradin ashtu edhe për kryeqytetet e tjera të Ballkanit, po aq sa vlen edhe për BE-në dhe NATO-n. Modeli aktual ushqen korrupsionin, për të cilin akuzohet sot Stefanović, dukuri kjo që e përshkon të gjithë rajonin, duke qenë një ndër pengesat më të vështira për përparimin e Ballkanit. Ky model duhet çrënjësuar, sepse nëse lejohet lulëzimi i korrupsionit, kjo jo vetëm që do të minojë qeverisjen e mirë në Ballkan, por edhe paqen që mezi u arrit në rajon. Dhe ky do të ishte një çmim shumë i lartë për t'u paguar. / Bota.al



Nga kryengritja e Toskërisë te hapja e shkollës nga Bejlerët e Cakranit

- Revolucioni Xhon-Turk -

Me shpërthimin e Revolucionit Xhon-Turk më 1908 në Stamboll, u kërkua ti jepej fund mënyrës autoritariste të sundimit të sultanit me krijimin e një kushtetute, që kërkonte zbatimin e të drejtave të kombeve brenda Perandorisë Osmane. Patriotët shqiptarë nuk mund ta linin rastin e artë, dhe nxituan të krijonin lëvizjen më të fuqishme kulturoro-arsimore, atë të Gjuhës Shqipe, e cila do të

mundësonte përfundimisht të shkruhej gjuha më e vjetër e planetit. Dinastia kishte kohë që po lëvizte me kapacitet të plotë dhe me librat e dhënë nga Sami bej Frashëri tashmë mësohej kudo. “Qysh nga fundi i shek. XIX, bejlerët e Cakranit kishin në konakët e tyre mësonjës shëtitës, herë Hamit Lumi e herë unë” “Ata na paguanin jo vetëm për katundin e tyre, por edhe për

katunde të tjerë, si Gorishovë, Buzmadh e Klos..” shkruan përfaqësuesi i Kolonisë së Bukureshtit, Kristo Karbunara.

Hapja e shkollës nga bejlerët e Cakranit

Për herë të parë zyrtarisht shkollën bejlerët e Cakranit e hapën në sarajet e tyre me një inaugurim madhështor dhe pjesmarrje të gjithë figurave sa patriotike, aq edhe kulturore, ku i pari foli Babë Dudë Karbunara.

Përfaqësuesi i Kolonisë së Bukureshtit Kristo Karbunara shkruan; “Shoqëria e Bukureshtit më pati dërguar me postën austro-hungareze në mol të Vlorës, pliko me vivlla e fletore shqipe më 1909 për bejlerët e Cakranit. Zotnia Hajredin kishte letër porosi me Jani Vruhon, Josif Bagërin e Nuçi Naçin, ndërsa Bektash Beu e Sulo Beu, me anën e Azis Vrionit ishin lidhur me Komitetin e Stambollit.. këto i çova kaq herë në Cakran tok me Ibrahim Abdullahun.” Shkolla nuk u mbyll dot, por dhe nuk e mori asnjëherë lejen, pasi administrata xhonturke filloi represionin..” Na erdhi dhe neve këtu leja për shkollën e Cakranit, e cila është një shkollë e vjetër, mbase nga më të

vjetrat në Toskëri dhe e cila gjer më sot është për mbajtur pa lejen zyrtare të guvenës..” shkruan gazeta “Dielli” e Bostonit.

Iluminizmi është tipar i rrallë fisnik, por ai duke ndiçuar me gjuhë e dije krahina dhe një popull të tërë, nuk mund të quhet më Rilindje Kombëtare, por Rilindje Europiane.

Spikatja e përfaqësuesëve të Dinastisë Cakrani nuk ishte garë mes tyre, por një shpirt i gjallë drite dhe lirie, një përzierje ndjenjash patriotësh dhe sakrificë luftëtarësh mbi një emblemë me emrin atdhe. Cili ishte në të vërtetë përfaqësuesi i saj Bektash bej Cakrani që Mallakstra do të personifikohej me të? “Në ka historia e Kryengritjes Shqiptare në Toskëri që të tregojë ndonjë burrë trim të madh, që me tërë fuqinë e patriotizmit dhe me dëshirën e flaktë për të fituar lirinë, pa dyshim njëri prej tyre është Bektash Bej Cakrani. Nuk është më shumë së tridhjetë e pesë vjeç, me një shat të derdhur, një trup robust e madhështor, është i katërti djalë i të ndjerit Kahreman Bej Cakranit. Është i martuar në Tepelenë me të bijën e një fisniku që rrjedh nga fisi i Ali Pashës. Që i vogël Bektashi tregonte një afsh të madh për

kombin tonë. Sa herë që i binte në dorë ndonjë libër i Naim Frashërit ai e këndonte dhe qante. Mbaroi shkollën e lartë “Sulltanie” në Stamboll dhe Fakultetin e Drejtësisë. Është mjaft i ditur dhe i kuptuar. Ndjenjat e tij kombëtare dhe kalorësinë e therorizmit për atdhe, i ka mjaft të zhvilluara. Flet dhe shkruan shumë mirë frëngjishten dhe turqishten, persishten, dhe më pak greqisht e gjermanisht. Tërë Mallakstra e nderon dhe e respekton si një shpëtimtar”. Përplasja me Perandorinë nga sfidë, po bëhej një realitet i paduerueshëm për të.. “Ndër të arrestuarit shënohen 13 vetë. Xhandërmaria xhonturke ka nxjerrë shpallje për arrestimin e Bektash Cakranit, Xhemil bej Vlorës, Osman Haxhiut, Hamza Isait, etj të cilët nuk gjenden në vend” thuhej në relacionin e konsullit austriak “Kraus” derguar ministrit të tij të jashtëm Alois Fon Erental, më 1909” Si e distancuar nga Perandoria,. Domeni ishte pothuaj jashtë kontrollit të saj; “Cakrani ndodhet në Mallakstrën e Poshtme dhe ne e quajshim Republika e Cakranit, mbasi çdo gja që ndodhte në Fier, a në Vlorë, a në Berat, nuk ndihesh aspak në Cakran, i cili ishte i qetë nga çdo



zhurmë shtetnore e Qeverisë Otomane” shkruan firmëtari i pavarësisë dhe mësuesi i shkollës së Cakranit, Thanas Floqi...

Kryengritja e Toskërisë...

Por Kryengritja e Toskërisë, fare e panjohur në histori, ishte iniciativë e patriotëve toskë, që kërkonin me çdo kusht bashkrendimin me Kryengritjen e Veriut, apo Gegërisë që udhëhiqej nga deputetët Nexhip bej Draga dhe Hasan bej Prishtina;

“Më 1911 kish ardhur në Stamboll Bektash Cakrani me të ndjerin Baki Gjebrea. Gjithmonë bashkoheshim në zyrën “Shqiptari” drejtuar nga Dervish Hima. E gjetëm të arësyeshme të ftojmë deputetët shqiptarë Nexhip Bej Dragën dhe Hasan Bej Prishtinën. Këtë barrë e mori përsipër Bektash Cakrani dhe Dervish Hima ku u mblodhëm në hotel “Imperial”, Nexhip Bej Draga dhe Hasan Bej Prishtina thanë që, për Kosovën kanë shpresën më të madhe për një kryengritje të përgjithshme. Për Toskërinë duhet arritur me çeta bashkimi gegë e toskë i kësaj kryengritje. Në Toskëri u nisëm, unë Bakiu dhe Bektashi” kujton Mihal Grameno. Por rreziku i shumfishtë nga të gjitha anët, e bëri kryengritjen të përqëndrohej tek Dinastia; Vetëm një kryengritje në Toskëri do na afroje me Gegët, do na nderoj në sy të Evropës.. kuptohi me Bektash Cakranin po dhe Bakin e Beratit, Tepelenën e Gjirokastrën e ngrihuni se humbmë” shkruan në një letër e Fazil pashë Toptani, Pandeli Cale dhe Alush Taka nga Korfuzi. Por problemi ishin armët. Pas përpjekjes së nëmbimit të tyre nga vetë oficerët Hajredin e Bektash bej Cakrani në kazermën e Beratit, dhe me dekonspirimin e aksionit që erdhi nga Vlorë, Dinastia e hedhur e tëra në luftë kërkon rrugë të reja; “Fjalosuni edhe me Zotin Bozio në

mund të na bjerë nga Italia njëmijë e pesëqind mavzenrë edhe sa të holla njërin. Pas dy a tri ditë do vij dhe unë atje dhe këtë fjalë ta gjej gati të bërë, i shkruan Bektash Cakrani mikut të tij, Hamza Isait, por këtë herë pas rreziqesh të panumërta arriti të blejë dhe të sjellë për kryengritjen 1500 pushke austriake.

“Beteja e Pazarit të Cakranit”

Beteja e Pazarit të Cakranit është epike jo sepse u kap i gjallë batalioni osman me 200 trupa, por bimbashi i tij Ismail Haki Libohova e braktisi dhe për këtë doli në gjyq. Përfaqësuesit e aristokracisë së tij, këtë radhë atdheu i thirri për komitë. “Drejt Beratit janë 400 burra në kryesinë e Bektash bej Cakranit, që ka shumë ndikim si dhe kryengritës nga Vlorë e Jugu që arrijnë mijra vetë, dhe nqs nuk merren masa sigurie popullsia e Beratit do të pranojë miqësisht kryengritësit dhe të zbatojë urdhërat e tyre, po të vijnë me forca më të mëdha se ato osmane, thuhet tek relacioni i konsullit Lejhanec ministrit të tij kontit Bertold. Produkti u pa shpejt dhe memorandumit i Sinjës, ka mbrojtjen ushtarake, përpilimin në frëngjisht dhe brendinë diplomatike të Bektash bej Cakranit, ku ishte prologu i pavarësisë që po vinte me shpejtësi.

Sipas këshillave dhe orientimeve austro-hungareze për rrezikun sllav të pushtimit në Luftën Ballkanike, shqiptarët kërkojnë me ngut të shpallin pavarësinë. Në një Vlorë krejt të pasigurtë prej dasive e përçarjeve prej kohësh ndodhet Bektash bej Cakrani së pari për të krijuar një situatë të qetë qysh mes vetë Vlorajve dhe organizimin financiar e të gjithanshëm të kuvendit të afërt. Si personazh kyç Ismail Qemali i beson atij udhëtimin



dhe nipit të vet Xhemil bej Vlorës, gjendjen në qytet; “Zotni Bektash Cakrani Vlonë. “Me urdhër të Ismail Qemal Beut, ju lutem pas dy orëve të ndodheni në zyrën post- telegrafike të atyrshme. Luigj Gurakuqi”, 22 Nëntor 1912” Pas bisedës 2 orëshe nisat telegrami; “Azis Pashë Vlionit Berat. E ardhmja e Shqipërisë u sigurua. Ismail Qemal Beu me shokët e vet, janë nisur nga Budapesti për në Vlorë, për t’u gjëndur në Mbledhjen e Përgjithshme Kombëtare që do të mbahet në Vlorë. Ata kanë kërkuar që t’u dërgohen atje kuaj ose karroca që deri nesër mbrëma duhet ti dërgoni. Lutemi na lajmëroni sa më shpejt. Bektash Cakrani” Por edhe në çastin më errët për të, perandoria nuk i lejon shqiptarët; “U informova konfidencialisht se mytesarifi ka marrë dje urdhër telegrafisht për të arrestuar Ismail Qemal Beun. Urdhëri ka ardhur pak me vonësë. raporton konsulli Rudnai nga Durrësi Vienës. Një letër i dërgohet Hajredin bej Cakranit, ku i kërkohet që të devijojë delegacionin nga rruga kryesore me evitimin e arrestimit të Ismail Qemalit; “Nuke di si e qysh po ti duhet t’u këmbesh udhë në rast rreziku e mundohi t’i futësh nëpër çifliqet e tua. Lumi do ket dalë e ka mbytur dynjanë pa të dua me bujq, me kuaj e me buaj më këmbë nuk e di si do t’ja bësh. Po të ndoth ndonjë e pa bërë, punën e luftën t’onë të filluar qëkur e muar lumi. Druaj se ajo punë do të vejë tek pushka mos hap batore i pari se do bësh dëm tek ndonjë yni po u përpoqët me t’a.”

Hajredin Cakrani me batalionin e vet do të mprehë buajt në këtë udhëtim dhe do të gjejë Ismail Qemalin me gjithë delegatët, të cilët kalojnë natën në sarajet e tij. Ai sjell në Vlorë për të ruajtur kuvendin batalionin e tij, që është garda e parë në historinë moderne, dhe vet si firmëtar i deklaratës, shpallet senator. E kush tjetër si Bektash bej Cakrani mund të organizonte e mbulonte financiarisht shtetin e parë shqiptar? Emërimi i tij si ministër thesari ishte vulosja në situatën e pashpresë, të cilën mund ta zgjidhte vetëm ai me të ardhurat e veta dhe kontributin e përhershëm e shekullor të dinastisë ndaj kombit, zyrtarisht si guvernatori i parë i shtetit të ri. “Do ti, do bëjë udhë shteti, s’do, do japë xhanë! Ndaj ti që nuk je kursyer qëkur për vatanë, si ke thënë e ke bërë, tani do zgjidhësh qesen tënde t’i vësh nga liratë e floritë e tua. Pa nevej tani që llafos kaq fuqi kemi, të të themi t’u shtofshin e mos t’u mbarofshin, është emërimi që i bën Kryeministri Ismail Qemali shkruan në kujtimet e tij firmëtari Hajredin, tashmë zvendës i ministrit të luftës Drralla, ku me ushtritë e tyre mallakastriote merrte pjesë në betejat më vrastare të mbrojtjes së Janinës. Ngutja e Qeverisë Provizore Vlorë për të shkuar në Londër, ku po vendosej fati i kufijve dhe e vetë kombit, bën që Ministri i Thesarit Bektash bej Cakrani të vinte në një kohë fare të shkurtër në punë dinastinë, për të sjellë të hollat e Londrës; “Po ju dërgoj njeriun tim të besuar që të


njoftosh sonte me urgjencë Sulo Beun dhe të dy duhet të sillni lira flori, se ato shkëmbehen andej, për 10 vetë që do venë tek anglezët dhe për të ndenjtur atje 20-25 ditë, se ata duhet të duken fisnikë”. Kjo ngjarje bëri që oborri habsburgas ti tërhiqte vërejtje ministrit të thesarit, ndërsa delegacionin e qeverisë provizore ta dëbonte si pa mandat për probleme të kësaj përmasë.

Por pas 29 korrikut 1913 që u njoh ndërkombëtarisht pavarësia e Shqipërisë, qeveria Vlorë në gusht, hedh hapin tjetër me tëpër ngut të ngrinte një bankë kombëtare në mungesë të plotë financash, me bankat private vieneze dhe milaneze. Me të drejtat pa kufi, si prerja e monedhës, dhënia e kredive duke lënë peng tokën, shitblerja me jashtë, bënë që ministrit të thesarit dinastia e tij ti trokiste fort për ti kujtuar detyrën, që e kishin qëndrim shekullor krah atdheut;

“Të ç’lirohesh Bektash Bej dhe ti, se një bankë si e kanë ata andej, do t’a bëjmë doemos dhe do lirohemi goxha, se kjo është tamam pamvarësi e vërtetë e jo ajo copë kartë, që të vërtetën n’a pruri më këtë sahat, dhe jam ca si plak për romuzet e tua!

-Po je dhe ca si i ri zotrote Ismail Bej, që të pleksesh në pazar me vatanë e t’a lësh në kumar, i thonë kësaj! Pa ma ç’pjegjo vezir, se qysh do marrim paratë e do lëmë peng vëndë, që kemi akoma varret e njomë të luftërave që s’kanë të pushuar? S’e kuptuaç pa sinuartë si të bëjmë pazar me vatanë, kur ne nuk kemi as sovranë e që të Mëdhënjtë na njohin si një copë guvernë kazaje, qysh do bëjmë shaka dhe të japim me konçesion? Qysh do t’a shesim pa e marrë akoma, pa për t’a gëzuar me këtë mëndje duket dielli që kur len! Vatani nuk është ngjallur akoma e s’ka sinuartë e tijë, zotrote thua ta humbasim në bast! Unë ngul këmbë që zotrote Bejefendi të mos j’a bëç këtij vatani këtë gjë, se nuk e ka hak../News24.al





INTERVISTË ME POETIN DHE KRITIKUN SHAIPI BEQIRI

SHKRIMI LETRAR ËSHTË TRAJTA MË E KRISTALIZUAR E GJUHËS

Bisedoi: Bujar SALIHU

Vitin që sapo shkoi është dashur të shënohej 50-vjetori i krijimtarisë suaj letrare, e cila nga kritika është cilësuar shumë e veçantë. A mund ta përmbledhni me pak fjalë se cili ka qenë përkushtimi juaj, vokacioni apo elementi përcaktues që e ka ngjizur kaq suksesshëm, shpesh edhe në heshtje të plotë, krijimtarinë tuaj gjysmëshekullore?

Këtë farë përvjetori ma përkujtuan dy institucione me të cilët lidhet fillimi i udhëtimit tim letrar: *Jeta e re* dhe Lidhja e Shkrimtarëve e Kosovës. Drejtori i revistës së famshme, D. Topalli dhe kryeredaktori A. Gashi më kërkuan falje që kishte rënë nga shtypi një pjesë e zgjedhur nga vepra ime në numrin e 70-vjetorit të revistës,

për ç'gjë as që e dija, prandaj kërkonin me ngulm t'u dërgoja diçka për numrin vijues. Ua dërgova një cikël poezish që përshkon tërë veprën time poetike të mbiquajtur: Lasgushiana. Soneti që i printe këtij cikli mban datën: Kallnor 1970, kurse rondeli që mbyllte atë: Kallnor 2020. Ishte një rastësi që më nemiti. Kjo habitje u bë e plotë kur kuptova vendimin e kryesisë së Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës që për vitin e kaluar më jepte Çmimin *Esad Mekuli*. Çuditërisht pothuaj çdo gjë e këtij jubileu tim u lidh me bardin tonë të madh, i cili ishte redaktori im i parë dhe mësuesi im i përhershëm në punën profesionale të redaktimit.

Tashmë kam hyrë në dhjetëvjetëshin e gjashtë të këtij kalendari kur, po ashtu, kam ndër duar librin tim të gjashtë të poezisë *Zgavrat e zhymta*. Të

them që unë në të vërtetë shkruaj shumë, por ndonjëherë hedh edhe më shumë, s'do të thosha ndonjë gjë të re. Unë kam tjetër dioptri për sasinë, për vëllimin etj. Por të bësh afër 300 poezi, qoftë edhe për më se një gjysmë shekulli, mendoj se nuk është një vëllim i vogël.

Cilët ishin librat dhe shkrimtarët që ju 'provokuan' duke ju tërhequr që t'i përkushtoheni letërsisë përgjithnjë. Do të ishte me interes për lexuesit tanë të dinë më shumë për cytjet e motivimet kyçe që keni pasur në udhën tuaj krijuese dhe nga kjo largesë kohe të mund ta veçonit qoftë edhe një çast të vetëm dhe të thoni se cili ishte fillimi juaj, apo mos kishte ai çast ndonjë gjë të magjishme, të pashpjegueshme?

Përkundrazi, ai fillim imi

s'kishte asgjë të magjishme, për të mos thënë banale, po them se ishte tërësisht prozaik. Poende unë së pari herë kam filluar të shkruaj prozë, për më shumë roman, të cilin e kisha filluar në vjeshtë të vitit 1969, kur nisa ta ndiqja shkollën e mesme në Prishtinë. Ndonjë vjershë të vogël bëja kur më bezdiste puna e mundimshme e endjes së pëlhurës të asaj proze të pazakonshme. Ndodhi ndërkaq dhe e braktisa shkollën në Prishtinë dhe u ktheva në gjimnazin e Besianës, ku kam vazhduar shkrimin e prozës deri në pranverë të vitit 1971. Nëse mund të ketë pasur diçka të magjishme lidhja ime me shkrimin, atë e përjetova dramatikisht në atë fillim: një krizë pakënaqësie të tmerrshme me çdo shkronjë që kisha hedhur në letër deri atëherë. Çasti kur i soditja gjuhët e flakëve duke shfletuar së fundit

herë me babëzi fletët e atyre dorëshkrimeve të mi nuk më shqiten kurrë nga kujtesa. Në atë vandak u dogj edhe soneti që përmenda më parë bashkë me jo pak poezi të tjera. Zjarrin i shpëtuan vetëm disa poezi që ndërkohë i kisha dërguar për botim në redaksi të ndryshme, midis të cilave edhe një fragment i asaj prozës që doli më vonë në të përditshmen *Rilindja* më 1972. Kjo lloj piromanie më ka ndjekur në gjithë jetën time, ndonjëherë me përmasa pak a shumë makabre.

Atëherë kisha nisur ta lexoja plejadën e madhe të Rilindjes sonë. Dashurinë për pjesën më të ndritshme të letërsisë dhe të historisë ma mbëltoi thellë në tërë qenien time të njomë mësuesi im i gjuhës dhe letërsisë, Kadri Kadriu, i cili ka bërë jo vetëm nxitje e ndikim, por ka vënë vulën vendimtare te

përcaktimi dhe përkushtimi im krijimtarisë letrare. Ai ishte mësuesi im i parë prej të cilit e mësova me rrënjë dashurinë për letërsinë dhe sidomos për gjuhën shqipe. Duhet të them që Kadri Kadriu ka mbetur për mua i vetmi mësues i vërtetë i papërsërtishëm në tërë jetën time.

Kur ju filluat të shkruanit, skena letrare e Kosovës, por edhe ajo e Shqipërisë, ishte relativisht mirë e konsoliduar. A keni gjetur mbështetjen e duhur të kolegëve tuaj më të vjetër dhe për çfarë do t'i mbani në mend ata?

Unë dhe brezi im kemi qenë me fat të madh për sa i përket formimit tonë intelektual dhe krijues. Periudha nga 1968 deri më 1981 ka qenë koha e një lulëzimi të vërtetë të arsimit e kulturës shqiptare dhe të Kosovës në përgjithësi. Fryma shqiptare thelbësisht ndihej dhe thithej në çdo por, sigurisht që në atë entuziazëm kishte jo pak eufori, e cila ishte e domosdoshme që mos t'i përfillnim sogjet e përgjimit që ishin vënë në çdo anë. Pothuaj tërë trupi arsimor dhe literatura nga Tirana qarkullonin pothuajse lirish ndër ne midis Prishtinës e gjithandej. Më vonë, pas vitit 1981, iu bë një hakmarrje e egër jo veç kryengritjes së përgjithshme të rinisë shqiptare, por edhe asaj pjesës intelektuale që i kishte rrëshqitur nga dora pushtetit pushtues!

Pra, dua të them se ajo skenë që përmendni ju kishte dy anë krejt të ndryshme. As unë nuk kam mundur t'i shmangem anës së saj të zezë. Egërsinë e saj e provova që në fillim, kur paraqita për botim librin e parë. Ajo goditje më parapërgatiti për udhën e mëtejshme. Tevona kurrë nuk kam lejuar që një varg, një fjalë e as një shkronjë e vetme të preket më te vepra ime.

Atëherë shumë të krijonim një pamje të plotë të letërsisë që krijohet në Shqipëri. Atje proza kishte bërë një shpërthim të dallueshëm, kurse në Kosovë printe poezia, e cila pikërisht në atë kohë kishte arritur kulmin e saj. Kur u kyça unë në atë rrjedhje të vrullshme, që krijuar disi paksa përdhunshëm një ndërprerje, sa qeshë ndier si një ishull! Vetëm katër-pesë vjet më parë qenë botuar 12-13 libra të parë të poetëve të rinj, kurse unë isha i vetmi autor i ri i atij viti kur doli libri im i parë! Vetëm 3-4 vjet pas meje, apo edhe në të njëjtën kohë, erdhën pjesëtarë të tjerë të brezit tim, si A. Mala, R. Musliu, N. Sopaj, A. Konushevc, A. Gashi, I. Berisha deri te R. Shala, H. Halimi, F. Rexha, L. Haziri, B. Çapriqi e shumë të tjerë në vazhdim. Unë i kisha shumë të afërt të gjithë këta që zura ngoje e shumë të tjerë, por afërsinë më të thellë e kam mbajtur gjithmonë me

brezin pararendës të shkrimtarëve, sidomos me A. Pashkun, T. Dërvishin, B. Musliun, Y. Shkrelin, I. Rugovën, M. Ramadanin, J. Gërvallën etj. Këtë përkatësi e ka vënë re dhe e ka shpjeguar me saktësi studiuesi i shquar I. Rugova.

Poet i thellësisë e saktësisë figurative, ju ka cilësuar që në fillimet tuaja krijuese pikërisht kritikun ynë i madh I. Rugova. A ka qenë e vështirë që krahas këtij vlerësimi dhe shumë të tjerëve kaq të lartë për poezinë tuaj, t'i mbeteni besnik stilit e gjuhës poetike, pra sa ka qenë i rëndësishëm mendimi kritik për formimin, evoluimin dhe ngritjen tuaj letrare?

Formimi im letrar është paksa më i ndërliqshëm, më kompleks, jo krejt i zakonshëm dhe sidomos jashtë amullisë. Pjesës më të madhe të pjesëtarëve të brezit tim zuri t'i hynte thellë në brendësi uji socrealist që vinte i dallgëzuar nga Shqipëria. Ky fenomen letrar sigurisht që dëmin e bëri të madh, e squlli së tepërmi një pjesë të poezisë, sa mund të vërehet lehtësisht edhe sot ai ndikim i gjithë deri përtej kohës kur brenda vetë Shqipërisë dolën tashmë dy-tre breza poetësh që janë shpëputur me shumë sukses prej asaj tradite të palavdishme.

Unë e kam mbajtur gjithnjë të fortë lidhjen me poetët tanë të mëdhenj të Rilindjes, trashëgimia e të cilëve në përmasat e modernitetit poetik shqiptar ishte përvijuar më thellë te poezia moderne e Kosovës, e cila ushqehet fort edhe me rrjedhjet më të avancuara të poezisë moderne evropiane e botërore.

Shquheni, gjithashtu, si një nga përfaqësuesit më të denjë të hermetizmit në krijimtarinë letrare të Kosovës, me një stil dhe gjuhë poetike jokonvencionale, të kultivuara pikërisht në atë kohë nga brezi i poetëve që përmendët. A ka qenë kjo rrymë letrare vetëm një dukuri e imponuar për të artikuluar mesazhe të kamufluar ndaj censurës apo si e tillë erdhi natyrshëm edhe nga ndikimet e motivimet e letërsisë së huaj, kryesisht të asaj evropiane?

Ka pasur një spekulim të gjerë me hermetizmin e letërsisë shqipe të Kosovës, sidomos të poezisë. Atë spekulim e keqpërdori madje edhe I. Kadare kur në kulmin e luftës së Kosovës zuri të çirrej kundër avangardizmit e hermetizmit të asaj pjese të letërsisë sonë, e cila, - shih ti çudinë! - nuk po mund të vihej në barrikadat e luftës çlirimtare! Më e zezë akoma është loja me markën tjetër të hermetizmit: shpërfaqja e një blirimi me të vërtetë spekulativ në emër të poezisë moderniste që mund të

ketë qenë gjithçka përveç poezil! Gjuha e poezisë së vërtetë moderne dhe mënyra e artikullimit të temave dhe ideve të caktuara sigurisht që ishte arti më madhështor i asaj kohe, sado që komunikimi i saj ishte paksa i vështirë, ndonjëherë dukej si i pamundur, por kjo ishte veç ana e jashtme e saj.

Më duhet të çel një parantezë edhe për anën e brendshme të këtij fenomeni të papërsëritshëm në gjithë letrat shqipe, sidomos në Kosovë, studimin e të cilit nuk e ka bërë askush deri sot. Lufta kundër këtij fenomeni letrar nuk është bërë në ambient të rrethuar me kulisat e mvëshura me mëndafsh e kadife. Ajo ka qenë një luftë e ashpër, e pështirë dhe ka zgjatur poende më shumë se vetë lufta e Trojës! Ka nisur në fund të viteve '60 në revistat *Fjala e Zëri* në Prishtinë me një polemikë midis Ibrahim Rugovës e Agim Vincës, duke pasur për shkas një vjershë të këtij të fundit si plagjiaturë e vjershës së Ismail Kadaresë *E shkruar më 31 dhjetor*. Që nga ajo përleshje estetike ylli i Rugovës nuk ka zbritur kurrë më poshtë se pozicioni sipëran që ka mbajtur gjithmonë. Ai nuk e mori si dafinë lavdie një triumf kaq të kristaltë, por vazhdoi punën studimore duke u përkushtuar përmasë të mëdha të helmatisur pa iu kushtuar shumë vëmendje. Të them kalimthi se, kur më kishte zgjedhur t'ia bëja redaktimin e librit *Pavarësia dhe demokracia* (1991), i kisha propozuar ta futnim atë polemikë si shtojcë të librit, por me pak fjalë më bindi se nuk ishte çasti i duhur!

Në anën tjetër, Ismail Kadare kishte botuar në Tiranë manifestin më të zi në letrat shqipe kundër letërsisë kulminante moderne të gjithë botës, ku me egërsi merrte në mbrojtje realizmin socialist si të vetmen


metodë krijuese me vlerë dhe plotësisht të pranueshme të kohës sonë, me titullin gjëmëtar *Autobiografia e popullit në vargje* (1971), të cilin pas nëntë vjetësh u përpoq ta zhbente duke e mbuluar me një libër krejtësisht tjetër me të njëjtin titull! Ndërmjet këtij emër-titulli që mbanin dy krijesa të ndryshme, Kadare te libri i poezisë *Koha* (1976) botoi vjershën *Shpjegimi për librat Besianës së vogël*. Traktatin e vet të pakmëparshëm estetik, shkrimtari ynë me famë botërore tash po e sillte në variantin e njëjtë me vargje poezie në një klimë të butë të ambientit familjar, siç mund të jetë bisedimi me fëmijën e padjallëzuar, të cilit ashtu engjullisht mund t'i flasësh për andrallat që sjellin poetët plëngprishës, të cilët, për ta mbajtur bibliotekën të pastër, mund edhe t'i hedhësh lirisht!

Njëmbëdhjetë vjet pas *Shpjegimit...* të Kadaresë, zëvendësideologu i socrealizmit të variantit më të egër në Prishtinë, Agim Vinca, botoi te libri i tij *Arna dhe ëndrra vazhdimin e dytë të kësaj komedie në vargje me titull Grandomanët*, tek e cila bënte saktësimin e vendit ku po bënin sehir poetët dekadentë shqiptarë, duke sjellë dëshminë e bisedave të tyre për Bodlerin, Rembon e jo pak gjepura të tjetra.

Unë përmenda vetëm disa qoka të dukshme të kësaj lufte të egër, e cila meriton një trajtim shumë më të thellë për të vendosur sfondin real ku duhet të vihen argumentet letrare për vlerësimin e një letërsie në periudhën e saj më dinamike. Kjo gjendje e kishte bërë edhe më të vështirë krijimin e letërsisë me prirje të tillë në Shqipëri, sa të mos mund të flasësh fare për botimin e saj, siç është rasti me poetin brilant Zef

Zorba, vepra e të cilit doli vetëm pas rënies së diktaturës. Kthetrat e përbindshme të asaj klime u kishin bërë dëm të pariparueshëm shkrimtarëve dhe poetëve më të mëdhenj që pati Shqipëria në atë kohë: Kasëm Trebeshinës, Fatos Arapit, Bilal Xhaferri, Frederik Rreshpes, Moikom Zeqos dhe jo pak të tjerëve. Dëmin shumëfish më të madh e vë re te brezat e pastajmë të shkrimtarëve të rinj. Për çudi, ky ndikim ka qenë me pasoja katastrofike edhe në Kosovë, ku është tejbartur me emblemën e ndryshkur të një patriotizmi parak në letërsi, sa shpesh ka krijuar situata absurde të cilat nuk i shpjegon dot askush me asnjë parim të vetëm estetik. Pas letërsisë me vlera të pakapërcyeshme të Anton Pashkut, Teki Dërvishit, Beqir Musliut, Ymer Shkrelit, Ibrahim Rugovës dhe dhjeta autorëve të tjerë të këtij kalibri e orientimi krijues, të kesh shfaqjen e një trumbe pa fund të skribomanëve postsocrealistë, për mua, para se të jetë e pakuptueshme, është tepër e dhimbshme.

Dua të them diçka më shumë për gjuhën. Vetë natyra e gjuhës së poezisë, përfitim i saj, ndodhet pothuaj në sferën e irracionalitetit, prandaj krijuesit i mbetet ta harmonizojë atë duke e bërë të rrokshme, të arsyeshme... Mendoj se shkrimi letrar është trajta më e kristalizuar e gjuhës. Të flasësh për letërsinë, së pari e së mbrami duhet ta shqyrtosh e qëmtosh gjuhën e saj, një aspekt që nuk ka të bëjë kryekëput vetëm me gramatikën! Ajo gjuhë vete përtej pushtetit torturues të gramatikës, sepse synimi i saj pikësepari është zbulues e rizbulues: të bëjë lidhje virgjërore të gjymtyrëve gjuhësore në një sistem të ngritur origjinisht nga themeli në kulm. A mjafton kjo gjë,



shtrohet natyrshëm pyetja. Përgjigjja është e prerë: Jo. Letërsia është vetë gjuha, por jo edhe e kundërta: gjuha s'mund të jetë letërsi. Kjo është një matematikë e thjeshtë sado që duket e çuditshme. Kështu është deri te kufiri ku shtrihet lidhja e gjuhës sidomos me muzikën dhe me artet e tjera...

Letërsia e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë, apo letërsia shqipe në përgjithësi, me çfarë bashkohen dhe çfarë i ndan? Cili është mendimi juaj për letërsinë shqipe sot?

Problemi është i thjeshtë për t'u kuptuar si i tillë, por tepër i vështirë për t'u zgjidhur si duhet. Atë duhet vështruar në tërësinë e tij, në një proces pak a shumë të ndërlikuar. Dikur kishte një sistem vlerësimi me shumë të meta e pengesa, kurse tash nuk ka më pengesa, por ato janë shkrirë e grumbulluar te të metat pa kurrfarë sistemi! Unë nuk e shoh problematik vërshimin e bërllokut të pafund letrar, siç duan të shfajësohen ata që mbajnë kaq gjatë kryqin e fajit në shpinë. Le t'i bëhet një soditje e përcipte tërë nëpunësisë së sotme letrare ndërshqiptare, që nga akademitë e të dy shteteve, nëpër ministritë e kulturës, ato të arsimit e të shkencës në gjithë botën shqiptare të këtyre 30

vjetëve; le të shihen fytyrat e atyre që kanë hartuar programet e mësimi të letërsisë në të gjithë nivelet e shkollimit; le të shihen edhe kreatyrat që kanë hartuar tekstet e mësimi të letërsisë dhe sidomos të mbahen mend shëmtirat që kanë përcaktuar lektyrën shkollore për të gjitha moshat e shkollarëve shqiptarë! Në anën tjetër, dihet që për të gjitha këto punë e plane jepen shuma kolosale parash të taksapaguesve shqiptarë, kurse ato i rrëmbejnë klanet mafioze të bordeve dhe këshillave më namzinj që ka pasur ndonjëherë bota jonë kulturore, shkencore, arsimore e letrare.

Në këtë gropë përçudnimi, shumëfish më të pështirë se gropa e dikurshme e Hajdin Sejdisë në mes të Tiranës, gjejnë gjuhë të përbashkët vëllazërore të rroposjes dhe katranosjes së çdo gjëje pjesëtarët e këtyre falangave të lidhura në një qark mafioz të imponimit të antivlerave të veta deri në shkallën e neveritjes.

Shkrimtarë të shkretë mediale të Shqipërisë, ku ende mbahen të mbyllura dosjet, në tërë këtë kotnajë më të padurueshme se të gjitha shkretëtirat e botës së bashku, të bezdisin duke cituar syzgurdulluar dosjet e vëna në tregun e zi të pasdiktaturës se si janë përgjuar e spiunuar shkrimtarët e Kosovës që kanë vizituar Shqipërinë e Enver

Hoxhës! Kryespiunë e xhelatë, në emër të një patriotizmi patetik me tru të kalbur, dëftojnë tash se cilët shkrimtarë të Kosovës kanë qenë të ndaluar dhe cilët nga ata vizitorë çfarë kanë biseduar në besim të thellë, sy më sy me vëllezërit nga gjaku e gjuha!

Tërë kjo zallahi zgjat qe më se 30 vjet të tranzicionit pa fund shqiptar! As sot nuk gjen dot një njeri të vetëm serioz atje që mund të thotë natyrshëm e besueshëm se si është e mundur që edhe pas kaq kohe pasdiktatoriale nuk është botuar në Shqipëri së paku nga një libër i vetëm i tre-katër shkrimtarëve më të mëdhenj të Kosovës, si Anton Pashku, Teki Dërvishi, Ymer Shkreli, Beqir Musliu etj.

Në vend se të merreshin me konsolidimin dhe kompensimin e asaj humbjeje të dhembshme që kishte pësuar gjithë krijimtaria jonë kombëtare në të gjitha fushat e saj për shkak të fatkeqësisë së ndarjes e përcopëzimit, këta mjeshtrë të çoroditur sikur fërkojnë duart në pritje të ndonjë preje të re për babëzinë e tyre. Në vend se me integrimin e gjithanshëm të vlerave letrare kombëtare, hartuesit e rinj të projekteve të mëdhenj kanë shpikur qarqet kulturore të pallangave që i promovojnë me triumfalizëm, duke futur në ta,

me hir e me pahir, të gjallë e të të vdekur, duke e vendosur veten gjithnjë në qendër të tyre. Qarqet e tyre të shpikur, të mbiquajtur shkolla letrare, edhe tingëllimin e kanë të çoroditur: Qarku i Prishtinës apo i Shkodrës; Qarku i Tiranës apo i Tetovës; Qarku i Muçivërrcit apo i Lazaratit!... Qendrat e këtyre qarqeve, që janë pretendentët e vet këtij organizimi të zbuluar kaq vonë, synim themelor kanë të shartojnë me metodat e incestit parak për copëzimin e mëtejshëm të gjenit shqiptar në shkallën që nuk kanë mundur ta bëjnë pushtuesit e as sunduesit tanë shekullorë!

Kjo është brenga ime. Kjo duhet ta mërzi të çdokënd që një realitet kaq të zi nuk e ndryshon dot për të mirën e afrimit e të bashkimit të plotë e të përhershëm të dy pjesëve tragjikisht të ndara të një kulture, të një gjuhe dhe të një letërsie që i përkasin një kombi dhe një vendi. Deri tash me këtë gjë janë marrë kryekëput njerëzit që më shumë se gjaku i kulluar, nëpër damarë iu qarkullon helmi i mërisë, i mosdurimit dhe i ligësisë.

Po letërsia shqipe në Zvicër?

Kur kam ardhur në Zvicër, para 25 vjetësh, kam gjetur një klimë të mrekullueshme kulturore, letrare e artistike me

frymë të pastër shqiptare të nivelit më të lartë. Ishin shumë aktivë Klubi Letrar *Faik Konica*, i udhëhequr nga Naim Kelmendi; Qendra Kulturore Shqiptare që udhëhiqej nga Agim Ramadani, Shoqata Kulturore Shqiptare *Mëmëdheu* e kryesuar nga Isuf Sherifi e jo pak të tjera. Ndërkaq tash pothuaj tërë kjo veprimtari është përqendruar dhe zhvillohet në kuadër të Shoqatës së Krijuesve Shqiptarë në Zvicër, e cila ka mbledhur krijues fushash të ndryshme. Unë vetë kam hyrë pa kurrfarë ngurrimi dhe jam bërë pjesëmarrës aktiv kudo që jam ftuar dhe kam pasur mundësi. Qe një kënaqësi imja e veçantë që në atë klimë ta kaloja kohën e parë të vështirë të mërgimit, për të vazhduar të thuash me të njëjtin ritëm edhe sot, aq më shumë kur në Prishtinë kisha lënë prapa vetes një shkretëtirë kulturore dhe fillimin e zvetënimit të veprimtarisë letrare që nga Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës e tutje, rrjedhojat e të cilit vihen re ende atje.

Ne jemi mbledhur të gjithë edhe këtu, në Zvicër e gjetiu, pa përjashtuar askënd. Ka shumë autorë të njohur e më pak të njohur këtu dhe gjithandej në vende të tjera. Mendoj që në Zvicër ka më shumë se 30 autorë që me veprat e tyre i bëjnë nder gjithë letërsisë



shqipe. Në mënyrë të veçantë do t'i përmendja tre poetë të shquar me përvojë e përkushtim të madh krijues, njerëz fisnikë e të dashur, si i ndjeri Vehbi Skënderi, pastaj Agim Shehu dhe Ndue Sinishtaj. Këtu gjeta dy miqtë e mi të shtrenjtë të letrave, njërin nga shkrimtarët tanë më të mëdhenj ndër të gjallët, Ymer Shkrelin, për të cilin nuk të bie të dëgjosh pothuaj asgjë gjithandëj, por edhe shkrimtarin tjetër të shkëlqyer, të ndjerin Agim Mala. Në atë fillim njoha shkrimtarin e shquar arbëresh, mikun tim shumë të shtrenjtë Françesko Miçelin, një emër shumë i nderuar dhe i shquar i letërsisë zvicerane.

Ndoshta ishte e rastit, por edhe ana zvicerane këtu më priti me ngrohtësi të jashtëzakonshme. Kanë mbetur për mua të paharrueshme leximet që organizoi me ne Qendra Zvicerane e PEN-it në Cyrih e në Bern. Pa vonuar më ftuan të futesha në Shoqatën e Shkrimtarëve të Zvicrës. Krahas një sërë takimesh e manifestimesh më të larta të tyre, ata Vaxhid Xhelilin dhe mua na zgjodhën përfaqësues të Zvicrës në Panairin e Librit në Frankfurt, ku Zvicra ishte mysafirja e tij kryesore; u bënë disa antologji edhe me poezinë time, u botua një libër antologjik i gjerë së bashku me poetët më të njohur zviceranë dhe shqiptarë, sikundër që më parë qe bërë një antologji e një reviste eminente në Munih. Sigurisht për tërë këtë aktivitet meritën më të madhe ka pasur miku i shqiptarëve dhe përkthyesi e prezantuesi më i përkushtuar i letërsisë, veçanërisht i poezisë shqipe në botën gjermane, i ndjeri Hans-Joachim Lanksch.

Letërsinë shqipe duhet të mësohemi ta shohim dhe ta trajtojmë në mënyrë integrale, të gjithëmbarshme. Autorët inferiorë, duke e pasur thellë në qenien e tyre ndjenjën drobitëse të vogëlsisë e të zilisë, bëjnë projekte ndarjesh e copëzimesh, si të vetmin shans për të gjetur një strehë për egon e tyre të sëmurë. Në këtë aspekt ne duhet të çlirohemi plotësisht nga frika e konkurrencës, sidomos nuk duhet tentuar të bëhet kapërcimi i saj me eliminime e denigrime, sepse shumësia, qoftë duke futur aty edhe kallaballëkun jo gjithnjë të mbarë, i vë në pah vlerat e vërteta të cilësdo krijimtari shpirtërore.

Për shumë kohë keni qenë redaktor i kulturës në një tribunë të madhe kulturore, letrare e artistike siç ka qenë revista e famshme e Kosovës 'Zëri i rinisë'. Cilat janë përvojat tuaja, nga kjo largesë kohe, çfarë mund të thuhet nëse do të kishim tani ndonjë revistë të kalibrit të tillë që me aq përkushtim promovon letërsinë

dhe kulturën tonë kombëtare?

Janë dy kohë të ndryshme, por tek ana thelbësore kanë shumëçka të përbashkët. Më ka rënë të merrem me shfletimin pothuaj të plotë të arkivit të *Zërit të rinisë*, kur pata bërë disa shënime me karakter monografik për të. Ai në fillim të daljes quhej *Zani i rinisë shqiptare* dhe në fund mbeti vetëm *Zëri*. Aty kam kaluar pjesën më të bukur të jetës dhe të punës sime. Ajo revistë ka pasur një rol shumë të madh emancipues dhe afirmues për tërë rininë shqiptare të Kosovës dhe të viseve të tjera nën Jugosllavi. Mund të them se nuk ka asnjë shkrimtar e as krijues tjetër që nuk e ka bërë hapin e parë aty... Asnjë studiues që mëton ta njohë dhe ta shkruajë historinë e Kosovës dhe të letërsisë e artit të saj nuk mund ta bëjë rrënjësisht e origjinisht atë pa e shfletuar imtësisht *Zërin, Rilindjen, Jetën e re, Flakën, Fjalën, Botën e re* etj. Sa mirë do të jetë kur të bëhet digjitalizimi i plotë i këtyre dhe shumë gazetave dhe revistave të tjera.

Të shtoj se në punën time si redaktor jam përpjekur të mbaj harmoninë brenda vetes, të cilën e konsideroj si vlerën më të lartë morale dhe intelektuale të një krijuesi, vlera që përfshijnë korrektësinë, paanësinë dhe diturinë e të vlerësuarit. Sigurisht që ndihem mirë kur shumë autorë nuk e fshehin mirënjohjen për mbështetjen që u kam bërë, por merita u takon në radhë të parë vetë atyre.

Të shtoj një fakt që e mësova së voni: në *Zëri* kam punuar në periudhën 1977-1993; për gjithë këta vjet aty kam botuar vetëm tri poezi të miat!

Për pjesën tjetër të pyetjes suaj, nëse mund të kemi tash ndonjë revistë të atij kalibri, po shtoj një gjë që duhet të kihet parasysh: *Zëri* ishte organi i Lidhjes së Rinisë Socialiste të Kosovës. Faktikisht aty zhvillohej një luftë e gjithëmbarshme e asaj politike, e cila zinte hapësirën mbizotëruese edhe në revistë. Ndoshta tingëllon e pabesueshme, por është shumë e vërtetë që unë gjatë gjithë asaj kohe mundimin më të madh e kam pasur në një luftë tjetër, të ruaj me ngulm integritetin e asaj hapësire që quhej *Rubrika e kulturës*, aq shpesh e kërcënuar deri te synimi që të hiqej fare! Tash, pas kaq kohe, shoh që në atë tryezë të madhe janë vënë për diskutim temat më të mprehta të kulturës, sidomos të letërsisë dhe të arteve të tjerë, që nga muzika, teatri, filmi, artet pamore etj. Dhe nuk janë vënë dosido, por me organizim të gjerë tryezash e formash të tjera të shprehjes së pikëpamjeve me një pluralitet të plotë.

Tash mundësitë janë të jashtëzakonshme edhe për

krijuesit e rinj. Ata duhet të bashkohen rreth boshtit të një ideje, me një koncept të qartë për një revistë me kriteret e parime të qëndrueshme, por në radhë të parë ta kenë seriozisht dhe të mos nisin ndonjë projekt sa për t'u argëtuar e vetëtallur! Unë po u jap atyre dy modele të shkëlqyera nga fletoraria shqiptare e shekullit të kaluar. I pari propozim imi: le të marrin të rinjtë e sotëm parasysh se çfarë kishte futur me aq vrull në amullinë e deriatëhershme të jetës kulturore të Prishtinës revista *Pejada*, që ishte organ i Rinisë Letrare të Kosovës në fillim të vjetëve '70, e udhëhequr nga Ymer Shkreli dhe Beqir Musliu dhe tërë brezi i jashtëzakonshëm i atyre shkrimtarëve të rinj. Për shuarjen e saj ishte gjetur një shkas banal ideopolitik, por thelbi ishte te mosdurimi i prishjes së amullisë që kishte krijuar brezi i shkrimtarëve më të vjetër, jo pak prej të cilëve nëpër kurrizin e letërsisë e shërbesave të tjera kishin arritur poste të lartë funksionarësh politikë e kulturorë, duke qenë poende edhe anëtarë të Komitetit Qendror të Lidhjes Komuniste të Serbisë! Propozimi im i dytë le të jetë modeli i një grupimi të rinjsh të Tiranës në fillim të vjetëve '90, menjëherë pas rënies së diktaturës, që nxori revistën *E përshme*, nga e cila doli një plejadë e shkëlqyer poetësh e shkrimtarësh, si Agron Tufa, Ilir Belliu, Luljeta Lleshanaku, Ervin Hatibi, Lindita Arapi e shumë të tjerë, të cilët sot përbëjnë shtyllën kryesore të letërsisë shqipe, siç e përbënin ata të plejadës së Prishtinës njëzet vjet para këtyre.

Në anën tjetër, a mund të keni ide se sa shuma parash japin ato ministri të shkreta kulture në Prishtinë e në Tiranë për kotnajtën pa fund të aq kanagjeqesh letrarë, muzikorë, teatrore, filmorë, sa të neveritesh edhe prej vetë letërsisë e artit që shpërfaqin e trumbetojnë shumëfish më mjerueshëm se amatorizmi i dikurshëm i shoqërive kulturore-artistike!

Çfarë roli ka pasur dhe sa kanë ndikuar në poezinë tuaj artet e tjera, si muzika, piktura, teatri, filmi?

Në fillim nuk e kam kuptuar thelbësisht ndërldhjen korresponduese të arteve, prandaj edhe nuk e kam ndier, sado që ajo mund të ketë qenë brenda meje me format e saj natyrale, të vetvetishme. Pas botimit të librit tim *Flatrat e gjymta* (1983), Enver Maloku, bashkë me regjisorin Nezir Sefaj, patën bërë një emision të filmuar në RTP me një zgjedhje poezish nga ai libër, duke futur aty një bisedë shumë interesante me mua. Duhet të më besoni që, me gjithë insistimin tim këmbëngulës,

ende nuk e kam parë atë emision edhe pas gati dyzet vjetësh! Disa kolegë që e kanë parë, sidomos autorët e emisionit, më kanë folur për anën filmike të poezisë sime, sa dikur më qe mbushur mendja që nga cikli për dëbimin e shqiptarëve në shkretëtirat e Andollit, një mjeshtër i hollë i skenës do të mund të bënte libreto për balet...

Unë, nga ana tjetër, dëgjoj shumë muzikë nga opusi i tërësishëm muzikor i botës, mirëpo në gjithë atë sasi nuk merr pjesë as sa gjysma e kohës që dëgjoj Vagnerin. Muzika e tij ka një ndikim të çuditshëm te qenia ime prej krijuesi: ajo muzikë më bën të ndiej pamundësinë dhe vogëlsinë e poezisë kundruall shkëmbinjve kristalorë të partiturave të gjeniut Vagner.

Si e shihni të ardhmen e letërsisë, të librit e të poezisë veçanërisht, në këtë kohë të zhvillimit të hovshëm të telekomunikimit, informatikës e 'antiletërës'? A mendoni se qytetërimi edhe më tej do të ketë nevojë për komunikim tradicional letrar, figurativ-metaforik, për letërsinë si të tillë apo në dekadat e ardhshme do të flitet vetëm për aspektin historik të saj. Thënë më shkoqur: mos është në të përënduar ndikimi i letërsisë? A duhet ta kenë këtë shqetësim posaçërisht dashamirët fanatikë të fjalës së bukur?

Bota i ka ligjësitë e veta edhe jashtë anës së vullnetshme të fuqisë njerëzore. Pjesa më qenësore e historisë së tërësishme të kësaj bote dihet e njihet, por ka një pjesë tjetër që nuk njihet fare ose dihet veç ndonjë gjë e pjesërisht për të. Pra fytyrës së historisë gjithmonë i rrinë përsipër hije të shumta. Ne përpigemi të vëmë një sinor se ku nisi katandisja jonë: copëzimi, dëbimi, gjymtimi, asimilimi etj. në një proces që rrok pak më shumë se dy shekuj? Unë përgjigjen e vë te çasti kur Evropa ia ndryshoi emrin Gadishullit Ilirik. Aty u ngul kazma që rroposi shumëçka. Dhe ku mbetën shqiptarët e kësaj hapësire gjeografike, e cila u shndërrua në një kazan me peshkve të historisë. Vendin e parë me numrin e shqiptarëve edhe sot e mban Turqia, e dyta është Greqia, kurse e treta mbetet Shqipëria me Kosovën dhe viset e tjera të copëtuara nga tre ujëqit e fqinjësisë rrotull nesh, sa pjesa jonë e asimiluar enda na quan shiftarë!

E bëra këtë parantezë paksa të gjerë të historisë, kur në mendje po bluaja të ardhmen e poezisë. Gjithë këto goditje të ashpra sigurisht që ndikimin nuk e kanë të vogël, por në një kohë do të bien nga vetëgoditja! Bota njerëzore e ka bartur si një flakadan të përjetshëm frymën e vet deri te koha jonë, poende kur nuk kishte as pergamenë e lëre më letër! Arti i

madh oral i shqiptarëve, shpirtin hyjnor të të cilin e ringjallën me aq forcë rilindësit tanë të papërsëritshëm që nga De Rada, Naimi, Mjeda dhe Noli, këto që nuk i tha historia e shtrembëruar dhe e kurvëruar, i artikuloi me forcën që nuk e mposht dot asnjë fuqi e destruksionit njerëzor dhe e barbarisë shfarosëse. Po cili ishte ai art kolosal baladash, legjendash, epesh dhe poemash me atë fuqi sa të mos e mposhtnin mileniumët e asnjë hordhie barbarore? Në mos paçin qenë pjesë e atij ansambli në një kapërcyell të caktuar epokash, vetë poemat zulmëmëdha të Homerit, *Iliada* e *Odisea*, them se janë motrat e së njëjtës rrëfanë gjenetike të visarit të pakapërcyeshëm poetik shqiptar.

Le të jetë edhe përgjigja ime në pyetjen tuaj me këto dy parabola tejshpjeguese dhe me këtë shtesë paksa cinike: arti i madh nuk guxon të shihet kurrë nëpër rrjetën e dendur të barishteve të shartuara njëra në tjetrën. Bota do të ketë nevojë për atë art madhështor aq sa do të ketë nevojë për bukurinë e shpirtit njerëzor!

Fare në fund, z. Beqiri, ju që tërë jetën me tërë qenien tuaj iu keni përkushtuar letërsisë, krijimtarisë letrare, ani pse nuk shquheni për ndonjë vepër të vëllimshme, për pesëdhjetë vjet keni botuar vetëm pesë libra poetikë, vazhdoni të shkruani apo mendoni se e keni thënë atë që keni dashur ta thoni? Le të jetë kjo një përgjigje mesazh për krijuesit e rinj.

Të shkruash pesë libra me poezi nuk më duket pak. Përkundrazi. Nuk më duket pak sidomos po të marrësh parasysh që mund të ketë së paku dyfish kaq gjëra që ndërkaq kam hedhur pa kurrfarë mëshire. Këtë mënyrën e shkrimit duke stivuar vjersha brenda kopertinash nuk e kam provuar asnjëherë. Mundimi im më i madh krijues është konceptimi dhe projektimi në hollësi i secilit libër, i cili duhet të ketë identitetin e vet të plotë, por edhe të lidhet në harmoninë e përgjithshme të një sistemi tërësor poetik. Unë nuk shkruaj asgjë të rastësishme. Ka ndodhur në fillimin tim krijues të kem shkruar ndonjë vjershë që e kanë pëlqyer ata që e kanë lexuar më shumë se të tjerat, por ajo nuk ka zënë vend në asnjë libër timin, sepse nuk ka pasur atë elementin e domosdoshëm - harmoninë me tërësinë!

Do të shkruaj deri në frymën e fundit. Por do të shkruaj kur ta ndiej nevojën ta plotësojë mozaikun tim të poezisë me diçka që nuk e prish harmoninë! E kam nisur me prozën, ndoshta edhe do ta përfundoj me të dhe me ndonjë gjë tjetër!

(Marrë nga numri i 11-të i revistës "Akademia")

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Envert
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
 'BUJQËSIA'
 TEL: 045/82 82 82**

Kuka: Në Sanjo do t'i përshtatemi klimatizimit të kohës dhe do të kemi përgatitje

PRISHTINË, 14 KORRIK - Ekipi olimpik i xhudos është nisur sot drejt Tokios së Japonisë, ku prej 23 korrik - 8 gusht 2021 do të mbahen Lojërat Olimpikë "Tokio 2020". Xhudistët, të prirë nga trajneri Driton Kuka, do të vendosen fillimisht në Komunën e Sanjos, ku do të zhvillojnë përgatitje para se të transferohen më 21 korrik në fshatin olimpik në Tokio. Ekipin e ka përcjellë në aeroportin ndërkombëtar të Prishtinës edhe shefi i misionit të ekipit olimpik të

Kosovës, Jeton Rudari. Krahas pesë xhudisteve: Majlinda Kelmendi, Distria Krasniqi, Nora Gjakova, Akil Gjakova dhe Lorian Kuka, me ekipin udhëtoi edhe Flaka Loxha, në cilësinë e sparing partneres. Para nisjes trajneri Kuka ka folur për fazën përgatitore që do ta zhvillojnë në Sanjo. "Qyteti Sanjo është nikoqir i ekipit tonë, qytet ky që na ka pritur edhe para Botërorit 2019. Atje do t'i përshtatemi klimatizimit të kohës dhe do të kemi përgatitje, në të cilat

nuk lejohen sparingjet me sportistë të tjerë, për shkak të pandemisë Covid 19. Unë besoj se ekipi është mjaftueshëm në numër për ta ndihmuar njëri-tjetrin, si dhe për ta mbajtur performancën dhe nivelin e përgatitjeve që tashmë e kemi arritur", ka thënë Kuka për Komitetin Olimpik të Kosovës. Të pesë xhudistët janë kualifikuar me normë olimpikë. Ekipi olimpik përbëhet prej 11 sportistëve. Pjesa tjetër e ekipit olimpik udhëton prej 19 korrikut.



Stublla: Ëndrrën që nuk e kam realizuar unë, mund ta jetësoni ju

PRISHTINË, 14 KORRIK - Basketbollistët e Kosovës A po stërviten dy herë në ditë para debutimit në arenën ndërkombëtare. Vashat e Kosovës do të debutojnë në Kampionatin Evropian për Shtete të Vogla në Qipro, që mbahet nga 20 deri më 25 korrik. Vashat dardane janë në grup me Qipron dhe Luksemburgun. Nënkryetarja e Federatës së Basketbollit të Kosovës, Linda Shala, para lojtarëve dhe stafit ka paraqitur Shemsije Stubllën, e cila ka qenë pjesë e gjeneratës së artë të Universitetit të Prishtinës. "Shema ka luajtur në këtë palestër



me shumë tifozë, më pas ka shkuar në Slloveni, ku ka luajtur dhe tani është trajnere për vajza të vogla dhe nënë e suksesshme e dy vajzave. Jam e lumtur që gjendem me të", ka thënë Shala. Ndërsa Shemsije Stublla ka mbajtur një fjalim shumë domethënës. "Më vjen mirë që po ju shoh. Ajo çka dua të them është se, kjo për ju do të thotë shumë. Unë ju kam lakmi. Vetëm këtë gjë nuk e kam arritur. Të vetëm ëndërr që nuk e kam plotësuar është të luaj për Kosovën. Ju duhet të jeni krenare me veten tuaj. Jam e sigurt se do të keni suksese. Mos u ngarkoni dhe

kënaquni në ndeshje. Unë kam luajtur deri në moshën 35 vjeçe. Edhe tani luaj si veterane dhe kam marrë pjesë në shumë gara ndërkombëtare. Edhe sot kur luaj, është si më parë, fitoren e shijoj si dekada më parë. Luani, kënaquni dhe mos u ndalni asnjëherë nga basketbolli, sepse gratë janë shumë të forta", ka deklaruar Stublla para vashave të Kosovës. Shemsije Stublla ka luajtur për Universitetin e Prishtinës deri në vitin 1989 për t'u transferuar më pas në Maribor. Ajo ka qenë lojtare aktive deri në vitin 2000, ndërsa tani jeton dhe vepron në Slloveni.

Gjilani transferon Prekazin nga Ballkani



GJILAN, 14 KORRIK - Skuadra e Gjilanit e ka transferuar futbollistin Arbër Prekazi. Mbrojtësi i njohur ka qenë pjesë e Ballkanit deri tash, kurse me Gjilanin ka nënshkruar kontratë për tri edicionet e ardhshme. "Sport Club Gjilani njofton se ka arritur marrëveshje me Ballkanin për transferimin e

futbollistit Arbër Prekazi. Marrëveshja ndërmjet klubit dhe futbollistit Prekazi është e vlefshme për tri edicionet e radhës. Prekazi luan në rolin e mbrojtësit të qendrës, teksa ishte pjesë e klubit edhe më parë për garat evropiane", thuhet në njoftimin e Gjilanit. Ndërsa futbollisti Arbër Prekazi

ka deklaruar: "Ju njoftoj që e kam mbyllur bashkëpunimin me FC Ballkanin. Kam kaluar kohë fantastike në Suharekë, me ç'rast dua t'i falënderoj së pari drejtuesit e klubit ne krye me vëllezërit Arsim e Bali Kabashi, punëtorët e stadiumit, bashkëlojtarët, trajnerët me të cilët punova, tifozët fantastikë

'Xhebrailat' dhe gjithë qytetin e Suharekës. Tashmë kam arritur marrëveshje me SC Gjilanin, klub i cili tashmë m'i ka hapur dyert dhe më është shndërruar në shtëpi të dytë. Faleminderit drejtuesve fantastikë të klubit Gjilani në krye me presidentin Florim Zuka dhe gjithë të tjerëve!", ka deklaruar Prekazi.

Kryetari Muharremaj pret kampionët e 'Ulpiana Cup'

SUHAREKË, 14 KORRIK - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka pritur në zyrën e vet Shkollën e Futbollit "Suhareka", kampion i trojeve shqiptare në "Ulpiana Cup". Grupmosha U-11 përfaqësoi denjësisht qytetin e Suharekës në

"Ulpiana Cup" duke u radhitur e para në mesin e 16 skuadrave nga Maqedonia e Veriut, Presheva, Shqipëria dhe Kosova. "Njomakët nga Suhareka, të udhëhequr nga trajneri Drilon Berisha, ishin pa konkurrencë dhe të motivuar në çdo ndeshje,

ku edhe arritën deri të titulli kampion. Shkolla e Futbollit 'Suhareka' bën gara në Lidhjen Rajonale të Futbollit në Regjionin e Prizrenit me këto grupmosha: U-7, U-9, U-11, U-13, U-15", ka shkruar Muharremaj në profilin e vet në "Facebook".



Sarri i jep edhe një mundësi Muriqit

ROMË, 14 KORRIK - Verën e kaluar Lazio shpenzoi një shumë të konsiderueshme parash për shërbimet e Vedat Muriqit, por paraqitjet e tij nuk ishin në nivelin e duhur. 27-vjeçari bëri 34 paraqitje për klubin romak në sezonin e kaluar, ku shënoi vetëm dy gola. Klubi i Serisë A e bleu Muriqin për

të shënuar gola si zëvendësues i Ciro Immobile, por kjo nuk ndodhi. Përveç kësaj, për t'i bërë gjërat edhe më keq, vlera e transferimit të sulmuesit tani ka rënë në rreth vetëm 9 milionë euro, shumë larg asaj që Lazio pagoi për ta blerë atë që ishte 18.5 milionë euro. Ishte një sezon për t'u harruar për Muriqin

dhe largimi i tij nga Lazio nuk përjashtohet. Sidoqoftë, trajneri i ri Maurizio Sarri dëshiron t'i japë çdo lojtari në skuadër një mundësi për t'u dëshmuar në stërvitjet parasezonale. Sipas gazetarit turk Yagiz Sabuncuoglu, Sarri ka ftuar Muriqin të marrë pjesë në kampin përgatitor për sezonin e ardhshëm

dhe varësisht nga paraqitjet e tij do të vendosë nëse qëndron ose largohet. Muajin e kaluar doli një raport që thoshte se Eintracht Frankfurt, Borussia Monchengladbach dhe Fenerbahçe kanë shprehur interesim për shërbimet e sulmuesit nga Kosova.



Syla: Nga fëmijëria kam dashur të luaj për vendin tim

PRISHTINË, 14 KORRIK - Dita-ditës po rritet numri i basketbollistëve të cilët luajnë në liga evropiane dhe vendosin ta përfaqësojnë shtetin e Kosovës. Një ndër ta është edhe Albatrit Syla. Ai sapo ka mbushur 18 vjet dhe është i gjatë 202 cm. Syla është pjesë e Kosovës U20. "Është nder shumë i madh që të jem pjesë e Kosovës U20. Kam kaluar shumë mirë me të gjithë që nga dita e parë. Më kanë pritur shumë mirë. Po kalojmë shumë mirë njëri me tjetrin dhe atmosfera është e mrekullueshme. Prej fëmijërisë kam pasur dëshirë të luaj për vendin tim", ka thënë Syla për faqen zyrtare të FBK-së. Ai është i lumtur që luan për Dardanët. "Kam pasur mundësi të luaj edhe për Finlandën. E kam parë që në Kombëtaren e Kosovës janë mundësitë shumë të mira. Djelmohat e Kosovës janë shumë të mirë dhe jam shumë i kënaqur deri më tani", ka shtuar tutje Syla, i cili ka qenë pjesë e grupmoshave të Finlandës. Ëndrra e tij është që një ditë të luajë për Kosovën A.



"Shpresoj që një ditë të luaj për Kosovën A. Për këtë jam duke u përgatitur. Të shohim se çka do të ndodhë në të ardhmen", përfundoi Albatrit Syla. Ai tani është pjesë e Omnia Basketball Academy, nga ku kanë dalë shumë lojtarë të njohur. Kosova U20 (M) do të marrë pjesë në Grupin E të FIBA U20 European

Challengers që do të mbahet prej 20 deri më 25 korrik 2021 në Sopron të Hungarisë. Në këtë qytet do të luhet edhe Grupi D me këto shtete pjesëmarrëse: Maqedonia e Veriut, Zvicra, Rumania e Luksemburgu. Kosova është në grup me Bjellorusinë, Hungarinë e Sllovakinë.

Federeri tërhiqet nga Lojërat Olimpike

CYRIH, 14 KORRIK - Pas disa javësh do të mbushë 40 vjeç, por Roger Federer nuk ka ndërmend të tërhiqet nga tenisi. Në Wimbledon veterani helvet u eliminua në çerekfinale pasi u mposht lehtësisht 3-0 me sete nga polaku Hubert Hurkaz, duke treguar se dëmtimet e shpeshta dhe vitet e shumta mbi shpinë e kanë frenuar në rrugën e tij drejt sukseseve. Dëshira e mbretit Roger ishte të përfaqësojë edhe për një herë të fundit Zvicrën në Lojërat Olimpike "Tokio 2020", por edhe këtë herë një dëmtim në gju është bërë shkak që Federeri të tërhiqet. 39-vjeçari i cili arriti ta fitonte medaljen e Argjendtë në Lojërat Olimpike "Londër 2012" me një postim në rrjetet sociale ka zyrtarizuar tërheqjen nga "Tokio 2020", pikërisht për shkak të një lëndimi, megjithatë Federeri nuk demoralizohet dhe shpreson të jetë gati për Slamin e fundit të vitit US Open. "Duhet të tërhiqem nga Lojërat Olimpike të Tokios për shkak të një dëmtimi në gju. Jam shumë i mërzitur, pasi ka qenë një ndër pikat



më të larta të karrierës sime sa herë kam përfaqësuar Zvicrën. Tani kam nisur periudhën e rehabilitimit në mënyrë që të kthehem në fund të verës. I uroj gjithë ekipit zvicëran fat",

ka thënë Federer. Roger Federer numëron deri tani 1 251 fitore në karrierë dhe 20 turne Grand Slam po aq sa edhe Novak Djoković e Rafael Nadal.

SHKURT

Leclerc: Ferrari në Silverstone si Italia në Evropan

Formula 1 rikthehet këtë javë në pistën e Silverstone, ku do të zhvillohet gara e Çmimit të Madh të Anglisë. Një pistë favorite për Mercedes, ku synon të lërë gjurmë edhe Ferrari. Ai që shpreson në një podium është Charles Leclerc, që këtë sezon nuk është ngjitur asnjëherë në podium. "Sigurisht që podiumi më mungon prej shumë kohësh. Gjithsesi, nëse shoh një foto të makinës së një viti më parë dhe asaj të këtij viti, ndryshimi është i madh. Jemi në rrugën e duhur dhe kemi një grup të fortë që po punon. Nëse ëndërroj podiumin në Silverstonë është një objektiv realist", ka thënë Leclerc. "Italia fitoi në Londër edhe pse nuk ishte favoritja kryesore. Një gjë të tillë mund të synojmë edhe ne për t'u dhuruar tifozëve tanë një kënaqësi. Unë jam i qetë për të ardhmen, pasi ka një energji pozitive dhe me Sainz ndihem mirë, duke punuar së bashku. Unë besoj te projekti Ferrari", ka shtuar Leclerc.

PSG-ja heq dorë nga transferimi i Messit

PSG-ja ka hequr dorë nga përpjekjet për të nënshkruar me Lionel Messin këtë verë si agjent i lirë. 34-vjeçarit i ka skaduar kontrata me Barcelonën dhe është i lirë që të negociojë me skuadra të tjera. "Marca", PSG-ja është në dijeni që katalunasit janë pranë të arrijnë marrëveshje për ritransferimin e Messit, andaj kanë hequr dorë nga ky transferim. Presidenti i Barcelonës, Joan Laporta, së fundmi ka dhënë mesazh optimist duke konfirmuar se negociatat janë duke shkuar mirë. Messi momentalisht është në pushime, pasi fitoi trofeun e parë internacional, atë të Kupës së Amerikës duke mposhtur Brazilin në finale. Vazhdimi i Messit është zhgënjyes për Neymarin, i cili ishte duke shpresuar të ribashkohet me mikun e tij në "Parkun e Princave".

Nedvedi konfirmon se Ronaldo nuk largohet nga Juve

Zëvendës-presidenti i Juventusit, Pavel Nedved, i ka siguruar tifozët se Cristiano Ronaldo do të mbetet në Torino. Ronaldo nuk ka dhënë ndonjë shenjë se do të largohet nga Juventusit gjatë kësaj vere, por ka pasur thashetheme në mediat italiane se ai mund t'i bashkohet ndonjë gjiganti tjetër evropian. Agjencia italiane e lajmeve ANSA raporton se Nedvedi i siguroi përkrashtet e Juventusit të cilit ishin mbledhur pranë Continassas për ta mirëpritur rikthimin e Massimiliano Allegri në klub, se portugezi nuk do të largohet. "Ai po vjen, ai po vjen", u përgjigj Nedved kur u pyet për Ronaldon. Ronaldo është duke i shijuar pushimet me familje pas Kampionatit Evropian dhe Nedvedi tha se ai do të kthehet në klub në ditët në vijim.

Dortmundi nuk e lëshon Haalandin, Chelsea mendon për Kanen dhe Lukakun

Borussia Dortmund nuk e ka ndërmend të heqë dorë nga Erling Haaland edhe përkundër asaj që Chelsea ka ofruar 175 milionë euro. "Sky Sport"

raporton se klubi gjerman e ka refuzuar ofertën e parë duke u bërë të qartë londinezëve se nuk kanë ndërmend ta shesin sulmuesin norvegjez. Në këto

kushte verdhezinjtë rrezikojnë ta humbasin sezonin e ardhshëm për 80 milionë euro, aq sa është klauzola, por nga kjo lëvizje edhe Mino Raiola, agjenti i tij, kërkon

40 milionë euro komision, në këto kushte transferimi i Haalandit të blutë bëhet thuajse i pamundur. Në anën tjetër, Chelsea kërkon me çdo kusht një

qendërsulmues për sezonin, për këtë arsye kanë kthyer vështrimin nga dy gjigantë të tjerë, Romelu Lukaku dhe Harry Kane.



Shoqëria Humanitare, Bëhëditë e Kosovës "Mëta Teresa"
The Kosovo Humanitarian and Charitable Society "Mother Teresa"
Humanitarina Društvo i Kosovës "Mëta Teresa"
38400 Prishtinë Rr. Agim Ramadani, p.m. Të 045313 38 542 864, Fax: 542 869,
Web site: www.motherteresasociety.org e-mail: motherteresasociety@yaho.com

CONTRACT NOTICE SERVICES

According to Article 40 of Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092

Date of the preparation of the Notice: 14/07/2021

Procurement No	Mentoring	003	2021	221
----------------	-----------	-----	------	-----

This notice has been prepared in the LANGUAGES:

English

SECTION I: CONTRACTING AUTHORITY

I.1) NAME AND ADDRESS OF THE CONTRACTING AUTHORITY (CA)

Official name: Kosovo Humanitarian Charitable Society "Mother Teresa"		
Postal address: str. Mujë Krasniqi n.n. Ulpiana U1/1		
Town: Prishtina	Postal code: 10000	Country: Kosovo
Contact point(s): Zef Shala	Telephone: 038-542-865	
Email: zefshala@hotmail.com	Fax: 038-542-869	
Internet address (if applicable):	www.motherteresasociety	

SECTION II: OBJECT OF THE CONTRACT

II.1) DESCRIPTION

II.1.1) Contract title attributed by the contracting authority: Mentoring and Coaching for 400 previous beneficiaries-returnees	
II.1.2) Type of contract and location of works, place of delivery or of performance (Choose one category only - works, supplies or services - which corresponds to the main part of the specific object of your contract)	
	<input checked="" type="checkbox"/> Services
II.1.5) Short description of the object of the contract Mentoring and Coaching for 400 previous beneficiaries-returnees	
II.1.6) Common Procurement Vocabulary classification (CPV) 93.000.000.-8	
II.1.7) Variants are accepted	No <input checked="" type="checkbox"/>
II.1.8) Division into lots	No <input checked="" type="checkbox"/>
II.1.11) Estimated contract value: 96,000.00	

II.2) QUANTITY OR SCOPE OF THE CONTRACT

II.3) DURATION OF THE CONTRACT OR TIME LIMITS FOR COMPLETION

Duration in months 3 month or days 90 (from the contract signature)
or
Starting 01/09/2021
Completion 30/11/2021

SECTION III: LEGAL, ECONOMIC, FINANCIAL AND TECHNICAL INFORMATION

III.1) CONDITIONS RELATING TO THE CONTRACT

III.1.1) Performance security required	No <input checked="" type="checkbox"/>
III.1.2) Legal form to be taken by grouping of economic operators to whom the contract is to be awarded (if applicable)	
III.1.3) Other particular conditions to which performance of the contract is subject	No <input checked="" type="checkbox"/>

III.2) CONDITIONS FOR PARTICIPATION

III.2.1) Eligibility Requirements: 1. Certificate of Registration 2. Fiscal Number Registration 3. VAT-Certificate if applicable Documentary evidence required Copy of documentary
III.2.2) Professional Suitability: 1. Licenses Registration Certificate 2. List of Employees professional and administrative staff 3. References of previous experience in same or identity projects Documentary evidence required: Copy of documentary
III.2.3) Economic and financial capacity 1. Tax Verification from Tax Administration of Kosovo for winner Organization 2. Certificate of Kosovo Judicial Council for winner Organization, Documentary evidence required: Copy of documentary
III.2.4) Technical and professional capacity 1. Inventory list of organization 2. Cars evidence of organization Documentary evidence required Copy of documentary

III.3) CONDITIONS SPECIFIC TO SERVICE CONTRACTS

III.3.1) Execution of services is reserved to a particular profession	No <input checked="" type="checkbox"/>
III.3.2) Legal persons should indicate the names and professional qualifications of the staff responsible for the execution of the service	Yes <input checked="" type="checkbox"/>

IV.1) TYPE OF PROCEDURE

IV.1.1) Type of Procedure	<input checked="" type="checkbox"/> Open
---------------------------	--

IV.2) AWARD CRITERIA

<input checked="" type="checkbox"/> Lowest price
--

IV.3) ADMINISTRATIVE INFORMATION

IV.3.1) Previous publications concerning the same contract	No <input checked="" type="checkbox"/>
IV.3.2) Conditions for obtaining tender dossier	
Time limit for receipt of requests for tender dossier: date from (19- 23).07.2021	
IV.3.3) Time limit for additional Information Date Until 30.07.2021 time 14:00	
Payable documents	No <input checked="" type="checkbox"/>
IV.3.3) Time limit for receipt of tenders date 16/08/2021 time 12:00 place Prishtina	
IV.3.4) Time limits is shortened for submission of tenders	<input checked="" type="checkbox"/> no
IV.3.5) Is tender security needed:	No <input checked="" type="checkbox"/>
IV.3.6) Tender validity period: date: 16/09/2021 days 30 or months 1	
IV.3.7) Tender opening meeting: Date 16/08/2021 time 14:00 place Prishtina	

SECTION V: COMPLEMENTARY INFORMATION

V.1) COMPLAINTS

Any interested party may file a complaint with the Contracting Authority according to article 108/A of the Law No. No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092, at the address specified in Section I of this Contract notice.

V.2) ADDITIONAL INFORMATION

Note: Economic operators will be entitled to submit a tender, request to participate and other documents required or permitted to be filed during the conduct of a procurement activity in Albanian, Serbian or English.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "FIZIOTERAPIA A&G" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me NRB:71251551, si dhe me nr. fiska: 601593066, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "FIZIOTERAPIA A&G", D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa bisnisom: 71251551, nr. fis: 601593066 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "FIZIOTERAPIA A&G" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 71251551, nr. fis: 601593066 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

